

AGIM ARIFI



DROGAT

çka duhet të dinë të gjithë

AGIM ARIFI
DROGAT- çka duhet të dinë të gjithë

Redaktor:
Nazmi RRAHMANI

Redaktore e gjuhës:
Zyrafete Shala

Redaktor i fotografive:
Agim ARIFI

Ballina:
Gordan Zovko dhe Agim Arifi

Realizimi kompjuterik:
Gordan Zovko

U shtyp në shtypshkronjën:
????????

Katalogimi në publikim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

178.8

615.214

613.83-053.6

Arifi, Agim

Drogat: çka duhet të dinë të gjithë / Agim Arifi. – Prishtinë: , 2018.–190 f.: ilustr.
me ngjyra; 25 cm.

Parathënie: f. 11-12. – Fjalori: f. 181-186. – Literatura: f. 187-188. – Shënime për
autorin: f. 189

ISBN 978-9951-06-202-2

AGIM ARIFI

DROGAT- çka duhet të dinë të gjithë

Ferizaj, 2023
(Shtëpia botuese)

Përmbajtja

PARATHËNIE.....	11
HYRJE	13
HISTORIA E SUBSTANCAVE NARKOTIKE.....	15
NARKOMANIA (SËMUNDJA E VARËSISË)	17
KRITERET E DEFINIMIT TË SËMUNDJES SË VARËSISË (NARKOMANISË).....	19
VARËSIA, VARËSIA FIZIKE,	
VARËSIA PSIKIKE DHE TOLERANCA	20
Varësia	20
Varësia fizike.	20
Varësia psikike	21
SI ZHVILLOHET VARËSIA?	22
SHKAQET E PARAQITJES SË SËMUNDJES SË VARËSISË (Narkomanisë).....	23
KLASIFIKIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE	25
A. SUBSTANCAT NARKOTIKE HALUÇINOJENE	27
Tipi i varësisë nga substancat narkotike haluçinogjene.....	28
MARIHUANA	30
Pasojat shëndetësore.....	32
Ndikimi i marihuanës në tru	33
Ndikimi i marihuanës në mushkëri	33
Ndikimi i përdorimit afatgjatë i marihuanës në mësim dhe sjellje.....	33
Ndikimi i marihuanës në shtatzëni.....	34
Ndikimi i marihuanës në sistemin imunologjik	34
Potencialet adiktive të marihuanës.....	35
Shenjat e abuzimit	35
Aplikimi i kanabisit në mjekësi	35
Disa fjalë rreth fushatave për legalizimin e marihuanës	36
HASHASHI	38
VAJI I HASHASHIT	39
SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË KANABISIT	40
LSD-ja (Lizergjidi apo dietilamidi i thartirës Lizergjine)	41
SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË LSD-së	43
PCP – ja, apo pluhuri i engjëllit	
(Fenciklidini, në bazë të formulës fenilciklohek silpiperidin)	44
STP-ja	46
IBOGANI.....	47
KËPURDHAT– Kërpudhat e shenjtë (Magic mashrooms)	48
PSILOCIBINI.....	50
MESKALINA (Peyote, Cactus Buttones, Big chief)	52
Efektet negative.....	52
AMANITA MASCARIA.....	53
KETAMINA	54
TATULLA (lat. Datura stramonium L.) -Skopolamini-	56

B. SUBSTANCAT NARKOTIKE STIMULUESIT APO PSIKOSTIMULUESIT	59
KOKAINA	60
Si krijohen efektet e kokainës?	61
Efektet negative, që i shkakton përdorimi i kokainës.....	62
Komplikimet shëndetësore, të cilat i shkakton keqpërdorimi i kokainës	63
Konsumuesit e kokainës dhe sëmundjet virusale, AIDS/HIV dhe Hepatiti A dhe B	64
Femra shtatzëne dhe kokaina	65
KRAKU (CRACK COCAINE).....	66
COCAETHYLENI (Alkooli + Kokaina).....	67
SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË KOKAINËS,	
KRAKUT DHE COCATHYLINIT	68
EKSTAZIA (MDMA– 3, 4-Methylenedioxy-N methamphetamine)	69
Historiku.....	70
Dozimi	70
Mundësia e shkakimit të varësisë.....	70
Pasojat e përdorimit të ekstazisë	70
Kundërlindikacionet	71
SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË EKSTAZISË	72
AMFETAMINA /Amphetamines/	72
METAMFETAMINA (methamphetamine, amphetamine, dexametaphine	
methylphetamina, dhe phenemetrazini)	74
Efektet afatgjata, të cilat i shkakton keqpërdorimi i metamfetaminës	75
Dallimi në mes metamfetaminës dhe stimuluesve të tjerë.....	75
SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË	
AMFETAMINËS DHE METAMFETAMINËS	77
PMA – Parametoxianphetamina	78
EFEDRINI	81
KHATI.....	83
Pasojat	83
KAPTAGONI.....	84
C. SUBSTANCAT NARKOTIKE OPIATE APO OPIOIDËT	87
OPIATËT APO OPIOIDËT	88
OPIUMI – Papaver somniferum	90
MORFINA	92
KODEINA.....	94
TEBAINA	96
HEROINA.....	97
Opiatetet gjysmë sintetike	97
OKSIKODONI	104
BUBRENORFINA	105
HIDROMORFINA.....	106
OKSIMORFINA.....	108
METADONI	109
TRAMADOLI.....	111
FENTANOLI.....	112
Simptomat, pasojat dhe shenjat e përdorimit të opioidëve ose opiatëve.	114

Ç. SUBSTANCAT NARKOTIKE DEPRESIVE APO DEPRESORËT	117
BARBITURATET	119
BENZODIAZEPINAT	121
GHB-ja (Gammahidroksibutirat)	122
D. INHALANTËT APO AVULLIMET KIMIKE.....	127
Tretësit avullues	129
Aerosolët	129
Gazrat.....	130
Oksidi i azotit	130
Nitratet	130
Mënyra e përdorimit të inhalantëve	131
Efektet afatshkurta dhe afatgjata të keqpërdorimit të inhalantëve	132
Pasojat shëndetësore të keqpërdorimit të inhalantëve	133
DH. STEROIDET ANABOLIKE.....	135
Pasojat e mundshme të shkaktuara nga keqpërdorimi i steroideve	141
E. SUBSTANCAT NARKOTIKE SHOQËRORE	143
TIPI I VARËSISË NGA ALKOOLI	144
DUHANI (NIKOTINA)	150
KOFEINA (Kafja)	156
SHENJAT, TË CILAT PARALAJMËROJNË KEQPËRDORIMIN E SUBSTANCAVE NARKOTIKE.....	158
SIMPTOMAT E PËRBASHKËTA PËR	
SHUMICËN E NARKOMANËVE.....	160
FAMILJA DHE NARKOMANIA	161
MJEKIMI I NARKOMANISË	
(SËMUNDJES SË VARËSISË).....	163
DETOKSIFIKIMI.....	165
METODA DRUG FREE	165
PROGRAMI ME METADON	165
TRAJTIME ME IBOGAN	168
METODA KIRURGJIKE	169
KOMUNAT.....	169
LAAM-i dhe ilaçet e tjera	170
NALOKSONI dhe NALTREKSONI	171
BUBRENORFINI	172
TERAPIA BIHEJVORIKE	172
TEORIA KOGNITIVE-BIHEJVORIKE	172
MJEKIMI I VARËSISË NGA KOKAINA.....	163
FEJA ISLAME DHE DROGAT	174
NË VEND TË PËRFUNDIMIT	178
SUMMARY	179
FJALORI	181
LITERATURA	187
SHËNIME PËR AUTORIN	189

PARATHËNIE

Shkrimi i këtij teksti nuk është bërë me ambicie për të hulumtuar në mënyrë shkencore dhe profesionale përbërjen e drogave nga aspekti kimik apo psikiatrik, as nuk ka të bëjë me ndonjë analizë sociologjike apo psikologjike; karakteri i tij është informativ dhe edukues. Si dëshmitar i jetës në Perëndim, ku modelet e reja të realitetit dhe reprezentacionit tjetër social ndryshojnë krejtësisht nga ato tradicionale, qysh herët kam vërejtur se përdorimi i kohëpaskohshëm i drogës¹ nuk trajtohet si koncept psikologjik dhe psikiatrik i patologjisë së drogës (i varësisë patologjike nga substancat narkotike), por si dukuri masive e lidhur me kultura të reja, përgjithësisht me përmbajtje normative, si rezultate të shoqërisë bashkëkohore. Inflacioni i përgjithshëm i vlerave morale dhe rënia e autoritetit në të gjitha segmentet e shoqërisë së civilizuar, minimizon postulatet kryesore të deritanishme - *përgjegjësinë*. Të rinjtë, apo një numër i konsiderueshëm i tyre, kanë prirje t'u largohen përgjegjësi sa më shumë që është e mundur; thjesht nuk dëshirojnë obligime. Në qendër të interesit të tyre janë modelet e konsumit dhe të argëtimit. Konsumuesit e drogave, në përgjithësi, janë të vetëdijshëm dhe të bindur se përdorimi i drogës është i dëmshëm. Në vlerësimet e tyre të rrezikut nga drogat, gjegjësisht në valorizimin e dobisë apo dëmit, caktohen vlera krejtësisht të reja nga ato tradicionale. Pasojave shëndetësore dhe pasojave të tjera u kundërvihet argëtimi, gjegjësisht konsumi, ku konsumi i argëtimit është më i preferuari. Argëtimi vjen në radhë të parë, pa marrë parasysh pasojat dhe dëmet nga droga. Përdorimi i drogave legale dhe jo legale, gjithnjë e më shumë është pjesë e mënyrës së jetës konsumuese. Ajo është blerja e pushimit, argëtimit dhe kënaqësive. Kufiri mes përdorimit të drogës si nënkulturë (subkulturë) dhe kulturës dominuese të të rinjve është duke u bërë gjithnjë e më i padukshëm.

Ky tekst është përgatitur jo vetëm për prindër, mësues, studentë e nxënës, por edhe për të gjithë ata të cilët i përcjellin dukuritë aktuale të shoqërisë kosovare. Jemi dëshmitarë të situatës së pasluftës ku ka filluar të përhapet një dukuri shumë e rrezikshme që mund të ketë pasojë katastrofale për ardhmërinë e kombit në përgjithësi, e që deri tash për ambientin tonë ka qenë e panjohur (pos rasteve minore), dukuri kjo që po e godit pjesën më vitale të popullit tonë. Keqpërdorimi i drogave (substancave narkotike), si çdo dukuri tjetër, shfaqet si rrjedhojë e veprimit të një sërë faktorësh, të cilët në vazhdimësi po e intensifikojnë ndikimin e tyre. Krahës faktorëve të brendshëm, janë evidentë edhe faktorët e jashtëm, që përfshijnë përgatitje të llojllojshme me qëllim të goditjes së pjesës më vitale të popullit shqiptar - *rinisë*, pikërisht asaj rinie që ka qenë bartëse e të gjithave proceseve shoqërore e politike, më konkretisht, që ishte promotor i të gjitha lëvizjeve të shekullit të kaluar dhe fillimit të këtij shekulli. Prandaj, ky tekst ka për qëllim që të ofrojë informa-

1 Fjala drogë është me origjinë arabe dhe rrjedh nga fjala *dora*, që në përkthim do të thotë ilaç apo substancë mjekuese. Për herë të parë është shkruar në shekullin XIV në një vjetar anglez. Shprehja *drogë* në një kuptim më të gjerë përdoret si term për substancat me origjinë bimore, kimike ose shtazore që përdoren për prodhimin e ilaçeve. Më shpesh përdoret për të nënkuptuar se fjala është për një substancë që, kur të konsumohet, ndryshon gjendjen e vetëdijes dhe funksionet e tjera psikike. Në literaturën e të gjitha gjuhëve sllave përdoret shprehja droga (drogë), por e gjejmë edhe në literaturën në gjuhën shqipe. Në gjuhën shqipe fjala drogë më tepër përdoret në kuptimin farmakologjik; si lëndë kimike ose me prejardhje bimore që përdoret për prodhimin e ilaçeve dhe si *narkotik*: i droguar, i narkotizuar. Mirëpo, në literaturën në gjuhën shqipe zakonisht përdoret shprehja **Substancë narkotike**.

tat më elementare për keqpërdorimin e substancave narkotike dhe pasojat të cilat i shkaktojnë ato. Prindërve do t'iu shërbejë që t'i fitojnë disa njohuri më bazike mbi substancat narkotike dhe veçoritë e përdorimit të tyre, sepse vetëm një nga pesëdhjetë persona e dinë p.sh. se marihuana, hashashi dhe vaji i hashashit prodhohen prej të njëjtës bimë - *kanabisit* (*Cannabis Sativa L*), ose çfarë efekti ka dhe sa zgjat efekti i "Ferrari-t" (logo e njërës prej drogave stimulative - *ekstazisë*).

Të rinjtë mund të kenë dobi të madhe nga ky tekst, sepse do t'i njohin disa nga rreziqet, të cilat nuk i dinë, por që vetëmashtrohen se i dinë. Shumë pak vallëzues dhe vallëzuese nëpër *party* (techno dhe të tjera), disko klube dhe kafiteri, nuk e dinë se tabletat e ekstazisë të përziera me substanca të tjera narkotike apo me alkool, nëse merren në afat prej një ore, mund të shkaktojnë vdekjen. Apo shumë pak e dinë se mbidozimi dhe përzierja e drogave ka pasoja tragjike dhe zakonisht përfundon me vdekje.

Ky tekst mund t'u shërbejë edhe ekspertëve të vërtetë të fushave të ndryshme të cilët merren me këtë dukuri si: psikologët, sociologët, punëtorët socialë, juristët etj.

Për të qenë sa më praktik, për të gjitha shtresat e lexuesve, është bërë përpjekje që teksti të shkruhet me një gjuhë më të qartë dhe më të kuptueshme, duke iu shmangur përdorimit të terminologjisë së sofistikuar.

Ferizaj, qershor 2022

KLASIFIKIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE

Një vështrim gjithëpërfshirës i përdorimit të substancave narkotike, si një dukuri individuale dhe shoqërore, nuk mund të anashkalojë çështjen e klasifikimit dhe grupimit të substancave narkotike. Problemet e hulumtuara dhe të treguara në lidhje me përkufizimin konceptual të substancave narkotike, ndikojnë drejtpërdrejt në vendosjen e substancave individuale në fushën e caktuar të konceptit, si dhe grupimin e tyre të ndërsjellë.

Gërshetimi i shprehjeve të ndryshme (të gjuhëve të ndryshme) që përdoren për substancat narkotike dhe ekzistenca e grupeve të tëra të substancave që nuk kanë statusin e substancave narkotike në shprehjet publike, ose që janë larg prej tyre në bazë të origjinës dhe përbërjes së tyre, por keqpërdoren gjerësisht (si është rasti me thithësit); gjë që nuk e lehtëson aspak klasifikimin e substancave narkotike. Konfuzion shtesë krijohet nga fakti se grupet sociale dhe profesionale që janë drejtpërdrejt të interesuar për çështjet e substancave narkotike (terapeutët, mjekët, farmakologët, kimistët, avokatët, psikologët, sociologët, si dhe përdoruesit) zhvillojnë dhe përdorin mënyrat e tyre të klasifikimit dhe grupimit të substancave narkotike.

Për këtë arsye, disa substanca narkotike mund të klasifikohen në kategori krejt të ndryshme. Për shembull, Amfetamina, për mjekët është një preparat¹⁹ i përshtatshme për zvogëlimin e oreksit. Juristët e shohin amfetaminën si një substancë psikotrope²⁰ që paraqet një rrezik të madh për shëndetin. Për psikologët, amfetamina është një stimulues i fuqishëm që çon në rritjen e aftësive motorike (lëvizëse), rritje të qëndrueshmërisë fizike, përqendrimit dhe gatishmërisë. Sociologët e shohin amfetaminën si një produkt fitimprurës të industrisë farmaceutike, e cila, me gjithë ndalimin ligjor, është gjerësisht e pranishme në tregun e paligjshëm të substancave narkotike, dhe është veçanërisht i popullarizuar në mesin e anëtarëve të klasës së mesme, studentëve dhe atletëve. Përdoruesit, nga ana tjetër, e klasifikojnë atë si një «ilaç mashkull» (emri më i famshëm, zhargon për amfetaminat është «mashkull» dhe «shpejtësia»).

Në përdorimin e gjuhës jo formale ekziston një ndarje e përhapur e substancave narkotike në «të lehta» dhe «të rënda». Substanca që çon në varësi psikike konsiderohet e lehtë, ndërsa ato që shkaktojnë varësi psikike dhe fizike konsiderohen të rënda. Edhe pse substancat narkotike mund të klasifikohen sipas llojit të varësisë, emërimi i secilës prej tyre si «e lehtë» është jashtëzakonisht problematik. Para së gjithash, gjendja e varësisë, edhe nëse është vetëm psikike, ajo paraqet një çrregullim serioz me pasoja të shumta shëndetësore dhe sociale. Për më tepër, karakteristika e zhvillimit të varësisë është vetëm një nga pasojat që mund të shfaqen pas përdorimit të një substance narkotike. Edhe substancat që konsiderohen më të butat, si kafeja dhe çaji, mund të çojnë në dëmtim serioz të shëndetit. Disa substanca të tjera «të lehta», si duhani ose kanabisi, çojnë në probleme serioze të shëndetit mendor dhe fizik pas përdorimit afatgjatë. Përcaktimi i disa substancave narkotike si të lehta do të thotë që masat e kontrollit, veçanërisht parandalimi, nuk duhet të jenë shtypëse, dhe që parandalimi dhe edukimi, duhet të kërkojnë mënyra për ta përshatur përdorimin e tyre në modelet socio-kulturore.

19 Lëndë kimike e përgatitur për kërkime, për eksperimente dhe për qëllime të ndryshme; përgatesë: preparat kimik (mjekësor).

20 Drogat psikotrope janë substanca që ndikojnë sistemin nervor qendror, duke ndryshuar mënyrën se si truri juaj përpunon informacione, të tilla si ndryshimi i disponimit tuaj, mendimet, perceptimet, emocionet dhe sjelljet

Në lidhje me ligjshmërinë (legalitetin), substancat narkotike mund të jenë:

- ligjore (legale), por të kontrolluara dhe të taksuara posaçërisht (p.sh. duhani, alkooli), si dhe ato të cilat lëshohen me recetë të mjekut (p.sh. anksiolitikët dhe analgjetikët) dhe
- ilegale (të pa ligjshme), të ndaluara me ligj (p.sh. kanabisi, heroina, kokaina).

Të gjitha substancat narkotike të ndara në bazë të prejardhjes mund të klasifikohen në tre grupe: Substanca narkotike *natyrore, sintetike dhe gjysmë natyrore- sintetike*.

Substancat narkotike natyrore, janë ato të cilat fitohen me përpunimin e fryteve të bimëve të ndryshme si lulëkuqja e opiumit, kërpët e ndryshëm, kërpudhat e ndryshme, etj. Shfrytëzimi i bimëve të caktuara dhe lëngu i tyre për qëllime të terapive apo efekte magjike është i vjetër aq sa është edhe dëshira e njeriut për t'i eliminuar dhimbjet shpirtërore dhe fizike. Një lloje i këtyre bimëve kanë pasur cilësi depresive, kurse lloji tjetër cilësi stimuluese. Një grup të posaçëm të bimëve e përbëjnë bimët lëngu i të cilave ka ndryshuar gjendjen e vetëdijes duke shkaktuar halucinacione dhe vizione të fuqishme. Substancat natyrore janë: marihuana, opiumi, kërpudhat magjike etj.

Shprehja *substanca narkotike sintetike* kryesisht ka të bëjë me substancat narkotike të cilat fitohen në mënyrë artificiale me përpunimin dhe bashkëdyzimin e elementeve të ndryshme kimike, si p.sh. LSD-ja, ekstazia, amfetamina, metemfetamina etj.

Kurse *substancat narkotike gjysmë natyrore-sintetike* janë ato substanca të cilat nga bima natyrore përpunohen më tutje në laboratorë të ndryshëm duke iu shtuar substanca të ndryshme kimike. Të tilla janë heroina, kokaina etj.

KLASIFIKIMI I SUBSTANCAVE NARKOTIKE NË BAZË TË CILËSIVE FARMAKOLOGJIKE DHE VEPRIMIT

Grupet e ndryshme profesionale dhe shoqërore të cilat janë drejtpërdrejt të interesuara për problemet e substancave narkotike (psikiatrit, mjekët, psikologët, sociologët, juristët, etj.) zhvillojnë dhe shfrytëzojnë mënyrat e veta për klasifikimin dhe grupimin e substancave narkotike.²¹ Autori i këtij teksti është përcaktuar për klasifikimin e substancave narkotike sipas cilësive farmakologjike të **veprimit**, mënyrë kjo e cila në literaturë është më e theksuara dhe i përgjigjet klasifikimit të **varësisë** nga substancat narkotike.

Në bazë të cilësisë së **veprimit** te njeriu, substancat narkotike mund të jenë:

- Substanca narkotike **halucinogjene**
- Substanca narkotike **stimuluese ose stimulantët**
- Substanca narkotike **opiate apo opioide**
- Substanca narkotike **depresore ose depresorët**
- Inhalantët** dhe
- Steroidët anabolikë**

21 Substancat narkotike mund të ndahen edhe në bazë të: prejardhjes, përbërjes kimike dhe karakteristikave tjera.



SUBSTANCAT NARKOTIKE HALUÇINOGENE

Tipi i varësisë nga substancat narkotike haluçinogjene

Halucinogjenët (Psikotomimetikë, psikodysleptikët) janë **substancia psikoaktive** që **nxisin halucinacione**²² dhe shkaktojnë ndryshime në perceptim, mendim dhe vetëdije. Njerëzit qysh prej kohërave më të lashta janë ballafaquar me substancat psikotropine të cilat quhen edhe halucinogjene apo psikozomimetike. Këto substanca nuk janë ilaçe, edhe pse disa prej tyre janë sintetizuar për të qenë ilaçe dhe ka pasur edhe përpjekje të përdoren në forma legale. Sot këto janë kryesisht substanca ilegale (të paligjshme) të varësisë, mirëpo përdoren edhe në farmakologjinë eksperimentale.

Prej viteve '60 me substancat narkotike haluçinogjene kanë bërë eksperimente me miliona konsumues të rinj, kryesisht të vendeve perëndimore, duke imituar rok yjet, për të cilët është ditur se konsumojnë substanca haluçinogjene, duke krijuar kështu nënkulturën e psikodeliktëve, filozofinë specifike të jetës, stilin e jetës, të shprehurit artistik edhe me paraqitjen e përbashkët politike paqësore-lëvizjen hipike. Është e sigurt se në rritjen e interesit për substancat narkotike haluçinogjene ka ndikuar zbulimi dhe sintetizimi i LSD-së. Me këtë rast shpesh harrohet fakti se përdorimi i substancave haluçinogjene me prejardhje bimë e kanë origjinën në të kaluarën e lashtë ku kanë qenë të lidhura me ritet religjioze. Ekziston mendimi se përfytyrimet e para mbi ekzistimin e perëndive dhe të forcave mbinatyrore, si dukuri, kanë qenë pasojë e veprimit fiziologjik të haluçinogjeneve. Shumë më vonë njeriu modern, i civilizuar, cilësitë e pazakonshme të bimëve të adhuruara ia ka përshkruar veprimeve të elementeve të caktuara kimike.

I pari që ka bërë hulumtime në lëmin e haluçinogjeneve ka qenë psikofarmakologu berlinas, Louis Lewin (1850-1929), i cili i pari këto substanca, me emrin "fantastikët", i ka radhitur në një grup të posaçëm farmakologjik, duke i dalluar prej substancave të tjera psikoaktive (narkotikët, psikostimuluesit). Lewini "fantastikët" i ka definuar si "substancia, të cilat shkaktojnë ekscitim"²³ cerebral në formë të haluçinacioneve, iluzioneve dhe vizioneve pas të cilave pason të humburit e vetëdijes apo simptomat në ndryshimin e funksionimit të sistemit nervor. Përveç këtij emërtimi të parë "fantastikët", në literaturë këtë grup të substancave narkotike e hasim edhe me shumë emra të tjerë: delirogjenët, depersonalizantët, eidetikët, orinogjenët, psikotikët, psikodelikët dhe shizogjenët. Në SHBA për këto substanca sot përdoret shprehja psikodelikët, të cilët, në vitin 1957 i pari i ka përdorur Humphry Osmond, neuropsikiatri nga Princetonea. Në shumicën e shteteve të tjera në botë (edhe në trojet shqiptare) përdoret shprehja halucinogjenë. Quhen edhe psikozomimetikë pasi që te konsumuesit shkaktojnë simptome të skizofrenisë, do me thënë të psikozave. Personat nën ndikimin e këtyre substancave "shohin, dëgjojnë dhe i ndjejnë" të pa ekzistuarit (të paqenët). Substancat e këtilla shkaktojnë opinione për vetveten dhe rrethin e vet. Haluçinacionet mund të përcillen me frikë, brengosje dhe mendime të tmerrshme.

Shpesh mendohet se mjetet halucinogjene, nëse përdoren për një kohë të gjatë, shkaktojnë dukurinë e varësisë. Këto substanca narkotike në parim nuk shkaktojnë varësi fizike, siç shkaktojnë narkotikët, disa ilaçe, alkooli dhe duhani. Ndërprerja e përnjëhershme e konsumimit të ndonjë substance haluçinogjene nuk shkakton sindromë të rëndë apstinenciale, siç është p. sh. rasti me heroinën, morfinën apo barbituratet. Mirëpo, pa marrë parasysh këtë fakt, substancat narkotike

22 Haluçinacionet janë perceptime të tingujve, aromave ose efekteve vizuale të cilat paraqiten pa ndonjë stimul të veçant por që në të vërtetë nuk janë të pranishëm (të vërteta). Haluçinacionet mund të jenë: vizuale, dëgjimore, të prekjes, të përjetimit, nuhatëse, etj.

23 Nxitje, stimulim, ngacmim.

haluçinogjene janë shumë toksike për organizëm dhe paraqesin rrezik të madh për shëndetin e njeriut. Vetëm një herë nëse përdoren, shkaktjnë reaksione të pakëndshme dhe fatkeqësi, kurse me përdorimin e tyre për një kohë më të gjatë shkaktjnë dëme të përhershme të sistemit nervor. Duhet të përmendet se gati asnjëherë nuk janë të regjistruara rastet e vdekjes të shkaktuara drejt-përdrejtë nga dozat e tepruara të ndonjërës nga substancat haluçinogje (për dallim nga substancat e tjera narkotike si p. sh. nga heroina).

Mekanizmi i veprimit të këtyre substancave te njeriu nuk është i sqaruar deri në fund. Supozohet se efektet haluçinogjene bazohen në ngjashmërinë e atyre lidhjeve me ndonjë substancë neurotransmitore. Pjesa më e madhe e lidhjeve haluçinogjene janë derivate të triptamin²⁴ dhe në molekulë përmbajnë unazën indole (LSD-ja, psilocibini, ibogaini, bufotemini). Këto lidhje, në mënyrë strukturale, janë të lidhura me serotoninin.

Duhet të theksohet se drogat haluçinogjene bimore, gjatë shekujve, kanë pasur rëndësi të madhe në terapi (mjekim), disa prej tyre janë përdorur si ilaçe universale, gati për të gjitha sëmundjet. Kanabisi është një nga ilaçet më të vjetra në histori, kurse hashishi edhe sot përdoret si ilaç tradicional në viset rurale të Lindjes së Afërt dhe të Largët e posaçërisht në Indi, në Afganistan dhe në Pakistan. Edhe në kohën moderne (rrethe viteve '60 të shek. XX) hulumtimi i këtyre bashkëdyzimeve ka përjetuar ngritje dhe rënie në vlerësimet lidhur me përdorimin e tyre në mjekësi në mënyrë zyrtare. Vlen të shtojmë se shërbimet policore, informative dhe ushtarake të disa shteteve, kanë tentuar t'i shfrytëzojnë haluçinogjenët sintetikë si mjete sekrete, të cilat kishin për t'iu shërbyer për qëllime kundër informative dhe ushtarako-mbrojtëse. Janë studiuar veprimet, të cilat me ndihmën e substancave të këtij grupi mund të shkaktjnë ndryshime në sjellje dhe me atë të arrijnë "shpëlarjen e trurit", e cila armikun e bën apatik dhe të nënshtruar ndaj sugjestionëve. Te substancat, të cilat kanë veprim të madh në doza shumë të vogla (si LSD-ja), janë hulumtuar edhe mundësitë për helmime masive dhe mbrojtjen prej tyre.

Në substanca të varësisë haluçinogjene bëjnë pjesë:

- Mariuhana (*THC-ja; Tetrahidrokanabinol, substanca aktive në mariuhanë*)
- LSD-ja (*Dietilaminë – lizergjinë*)
- PCP (*Fecildini; pluhuri i engjëllit*)
- STP (*4-metil-2,5- dimetoksimetilpentilaminë*)
- Ibogaini (*Substanca aktive e kërpudhave; Amanita muscaria*)
- Kërpudhat magjike (*Psilocibe, Panaeoluse dhe Copelandia*)
- Psilocibini (*Substanca aktive e kërpudhës meksikane; teonnakati*),
- Meskalini (*Substanca aktive e kaktusit meksikan; Pejotla,*)
- Amanita maskarai
- Ketamina
- Tatulla (*Skopolamini, Substanca aktive në bimën Datura stramon*) dhe
- Bufotemini (*Substanca që gjendet në jargën e disa bretkosave*).

24 Triptamina është një alkaloid monoaminë që gjendet në bimë dhe kafshë.

MARIHUANA

KANNABISI (MARIHUANA) (MARIHUANA, HASHASHI DHE VAJI I HASHASHIT)

Marihuana është substancë narkotike! Shumë njerëz e veçanërisht të rinjtë, nuk duan të pajtohen me këtë përkufizim, megjithëse është vërtetuar shkencërisht. Në të njëjtën kohë, marihuana është një substancë narkotike që përdoruesit e provojnë së pari (të parën). Për shkak të çmimit të ulët dhe lehtësisë për ta siguruar, të rinjtë atë tashmë e provojnë që në shkollën fillore. Fatkeqësisht, kufiri i moshës po lëviz gjithnjë e më shumë, në mënyrë që varësia po regjistrohet edhe te fëmijët e klasave të ulëta.



Vetë prindërit shpesh kontribuojnë në statistika të tilla shkatërruese. Duke menduar se kjo nuk mund t'u ndodh fëmijëve të tyre, sepse ata kanë një marrëdhënie të hapur e plot besim mes vete. Zakonisht, të moshuarit nuk i vërejnë shenjat e para të abuzimit, kështu që vetëm kur zhvillohet një varësi e rrezikshme psikologjike, ata fillojnë të preokupohen me zgjidhjen e problemit. Situata përkeqësohet më tej nga fakti se marihuana është zakonisht një hyrje në botën e narkotikëve më të rëndë.

Gjithashtu, marihuana është substanca narkotike më e përhapur në botë. Sipas të dhënave më të fundit nga Kombet e Bashkuara, nga 350 milionë njerëz që përdorin substanca psikoaktive, marihuana është e pranishme në më shumë se 250 milion raste.²⁵

²⁵ Europe Ibogain Center

Marihuana është bimë, e cila përmendet në shkrimet e lashta. Hulumtimet arkeologjike kanë vërtetuar se marihuana ka qenë e njohur dhe me siguri është përdorur, qysh para 8500 vjetësh. Ekzistojnë tri lloje kryesore të marihuanës të njohura me shprehjet latine: *Cannabis sativa*²⁶, *Cannabis indica*²⁷ dhe *Cannabis ruderalis*²⁸.

Fjala *marihuanë* rrjedh nga fjala portugale *marangua* që do të thotë bimë joshëse, tërheqëse apo ngashënjyese. Emri i vërtetë për këtë bimë është *Cannabis sativa* L. Në gjuhën shqipe është e njohur me emrin *kërpe*²⁹ apo *kanp-e*. Kjo është bimë një sezonesh jo atraktive, me fletë dhëmbore që rritet deri në 120 cm, mirëpo është e mundur që të rritet me lartësi edhe më të madhe. Kultivohet nëpër fidanishte, në sipërfaqe të vogla, por edhe në hapësira të mbyllura. Marihuana kultivohet me shumë sukses në klimën mediterane. Mbillet në pranverë dhe i nevojiten disa muaj (zakonisht 4 deri 6) deri sa të vilet. Kultivimi i marihuanës kërkon shumë diell dhe ujë. Në viset me klimë të papërshtatshme kultivohet në hapësira të mbyllura me ndihmën e ndriçimit halogjen. Në këto kushte rritet më e vogël (afro 50 cm), mirëpo ka veprim tjetër dhe është më e fortë. Marihuana kultivohet gati në të gjitha pjesët e banuara të botës dhe hyn në grupin e drogave psikodelike apo halucinogjene me LSD- në, PCP-në, STP-në, Meskalinin, Psilocibinin etj., mirëpo kjo është substanca më e butë dhe më e dobët nga të gjitha substancat narkotike halucinogjene.

Ekzistojnë mbi 200 emra vetëm për marihuanën; te ne zakonisht përmendet shprehja “bari”. Por përmendet edhe si *joint*, *pot*, *dope*, *reefers*, *hash*, *ganja*, *skunk*, *vutra skun*, *draw*, *grass*, *weed*, *bush*, *puff*, *light*, *hash*, *smok*, *ganxhi*, *xhixhek* etj. Zakonisht përdoret si cigare (e cila quhet “joint”- xhoint) apo në llullë ose nargjile (boinb pipe). Mund të hahet duke e futur në keks apo biskota ose pihet me çaj. Ekzistojnë faktet që konsumuesit e rregullt të marihuanës mund të bëhen fizikisht e psikikisht të varur nga efektet e saj.

Substanca aktive kryesore në marihuanë është **THC-ja (Delta-9-tetrahydrocannabinol)**. Në vitin 1988 është zbuluar se membranat e qelizave të caktuara përmbajnë receptorë proteinikë, të cilët e lidhin THC-në. Kur të vendoset THC-ja në trup (organizëm) ajo krijon një seri reaksionesh, të cilat shkaktojnë shqetësime dhe **eufori**,³⁰ që përjetohen gjatë përdorimit të marihuanës (në formë të cigares apo me anë të përtypjes). Marihuana prodhohet prej fletëve dhe luleve të terura (thara)

26 Sativa prejardhjen e ka nga Kolumbia, Meksiko, Tajlanda dhe Azia Juglindore

27 Indica është tradicionalisht burim i hashashit, kurse prejardhjen e ka nga Maroku, Afganistani, India dhe Tibeti.

28 Ruderalis prejardhjen e ka nga Rusia, Polonia dhe vendet e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore ku klima është më e ftohtë.

29 Në bazë të agronomisë kërpet ndahen në gjashtë lloje:

Kërpi për fije (pejzë) – i cili përdoret në industrinë e tekstilit, e që mund të përpunohet dhe të fitohen lloje të ndryshme të tekstilit, të cilët janë shumë të qëndrueshëm. Edhe *jeansat* e parë, *Levi's*, janë bërë prej tekstilit i cili është pë punuar nga fijet e kërpit.

Kërpi për kokrra - i cili kultivohet për prodhimin e kokrrave, të cilat para se gjithash përdoren për prodhimin e vajit dhe si ushqim për zogjtë.

Kërpi për farë - i cili kultivohet për fitimin e farës për mbjellje dhe reprodukimin e tipit të ri të kërpit.

Kërpi i hashashit – kultivohet për prodhimin e mjeteve narkotike si marihuana, hashashi dhe vaji i hashashit etj. që zakonisht quhet cannabis sativa.

Kërpi i egër – gjendet si egjër.

Kërpi për dekorim – përdoret si bimë dekorative

Pos llojit të katërt (kërpi i hashashit) llojet e tjera të kërpit konsiderohen si kërpe industriale dhe kultivohen në mënyrë legale.

30 Në gjuhë të rrugës: trip, high. et

të Cannabisit të grimcuara, të pasura me rrëshirë (në shumicën e rasteve të bimës femër)³¹ që merren në fazën e lulëzimit apo pas lulëzimit dhe te ne njihet si “bari”. Mirëpo prej të njëjtës bimë, prej luleve të Cannabisit, gjegjësisht prej rrëshirës (dyllit) të pastër, prodhohet **Hashashi**, i cili si drogë është 10 herë më i fortë se “bari” i thjeshtë. Prej hashashit fitohet forma më e fortë e Cannabisit, **Vaji i hashashit**, i cili mund të përmbajë edhe më tepër se 30% të THC-së.



Pasojat shëndetësore

Cannabisi dhe efektet negative te njeriu kanë qenë objekt i studimeve në shumë lëmenj të ndryshëm. Mjekësia e përshkruan si shkaktar i sëmundjeve psikike që vijnë nga përdorimi i kësaj droge. Përdorimi i Cannabisit mund të shkaktojë bronkitin dhe karcinomën e mushkërive. Është vërtetuar se Cannabisi i dëmton kromozomet dhe ka indikacione se mund të jetë faktor i formimit të sëmundjeve malinje në trupin e konsumuesit. Në të vërtetë, fjala është për rrëshirën, e cila mund të ndikojë në metabolizëm në disa mënyra dhe më të rrezikuara mund të jenë organet e frymëmarrjes. Në lidhje me formimin e qelizave të kancerit në trupin e përdoruesit të marihuanës flasin edhe hulumtimet, të cilat kanë të bëjnë me ndikimin e marihuanës në funksionimin e sistemit imunologjik të njeriut. Raportet tregojnë se si marihuana ndikon në çrregullimin e sistemit imunologjik. Te femrat, përdorimi i kësaj substance narkotike mund të çrregullojë ciklin menstrual dhe të ndikojë në sterilitet. Sa u përket funksioneve intelektuale është e qartë se cannabisi ka ndikim duke shkaktuar variacione të ndryshme negative, të cilat reflektohen në aftësinë e aktiviteteve intelektuale gjatë dhe pas përdorimit të substancës narkotike. Për efektet negative psikike në

31 Bima mashkullore, për dallim nga bima femër, është pak më e gjatë, nuk ka shumë degë dhe lulëzon disa ditë më herët se bima femër.

mënyrë të qartë theksohet se gjendjet e frikës, panikut dhe paranojës mund të lajmërohen nëse përdoret cannabisi. Gjithashtu, kur është fjala për psikozat, gjegjësisht për çmenduritë, ndikimi i Canabisit e stimulon edhe më tepër paraqitjen e kësaj sëmundje. Psikiatrit më së shpeshti përmendin edhe përdorimin e Cannabisit si njërin ndër shkaktarët e shpeshtë të këtyre sëmundjeve.

Efektet afatshkurta, të cilat i shkakton përdorimi i marihuanës janë problemet me kujtesën dhe të mësuarit, perceptimi i shtrembëruar, të menduarit e vështirësuar, zgjidhja me vështirësi e problemeve, koordinimi jo i mirë, të rrahurat e shpejtuara të zemrës, ankthi dhe sulmet e paranojës.

Ndikimi i marihuanës në tru

Hulumtuesit kanë zbuluar se THC-ja e ndërron mënyrën në të cilën informata vjen deri te truri dhe e cila përpunohet në hipokampus. Hipokampusi është pjesë e sistemit limbik të trurit, i cili ka rëndësi të madhe për mësimin (për të mësuarit), kujtesën dhe integrimin e përvojave emocionale dhe motivacionet. Hulumtimet kanë treguar se neutronet në sistemin e përpunimit të informatave në hipokampus dhe në aktivitetin e fijeve nervore, kanë qenë të penguara me prezencën e THC-së. Hulumtimet më të reja tregojnë se përdorimi i marihuanës për një kohë të gjatë krijon ndryshime në tru, të njëjtat ndryshime të cilat i shkakton edhe përdorimi i drogave të tjera.

Ndikimi i marihuanës në mushkëri

Personat të cilët e konsumojnë rregullisht marihuanën mund të kenë probleme me sistemin respirator, të njëjtat probleme, të cilat zakonisht i kanë duhanxhinjtë. Ata mund të kolliten çdo ditë dhe të qesin jashtë gëlbasën, mund të kenë simptome të bronkitit kronik e të karcinomës së mushkërive, si dhe mund të ftohen më shpesh. Nëse vazhdojnë të marrin marihuanë, mund të shkaktohet funksionimi anormal i mushkërive si pasojë e dëmtimit apo të shkatërrimit të pëlurës së mushkërive. Pa marrë parasysh prezencën e THC-së sasia e katranit të cilën e marrin gjatë pirjes së marihuanës, si dhe niveli i karbon-monoksidit, i cili absorbohet, është tre deri pesë herë më i madh sesa te konsumuesit e duhanit. Kjo ndodh për shkak se shfrytëzuesit e marihuanës më thellë e thithin tymin dhe më gjatë e mbajnë në mushkëri, si dhe për shkak se tymi i marihuanës nuk filtrohet. Edhe pse nuk është vërtetuar se dëmi i marihuanës në sistemet e organeve, ka indikacione se mund të jetë faktor në paraqitjen e sëmundjeve malinje në trupin e shfrytëzuesit të marihuanës. Fjala është për rrëshirën (dyllin), e cila mund të ndikojë në metabolizëm në disa mënyra, kurse më të rrezikuara, siç theksuam më parë, janë organet e frymëmarrjes. Hulumtimet më të reja kanë vërtetuar se marrja e marihuanës në të njëjtën kohë me substancat e tjera narkotike, mund të shkaktojë rrahje shumë të shpejta të zemrës si dhe shtypje të lartë të gjakut.

Ndikimi i përdorimit afatgjatë i marihuanës në mësim dhe sjellje

Hulumtimet, të cilat janë bërë një kohë të gjatë në mesin e nxënësve të shkollës së mesme, tregojnë se ata të cilët përdorin marihuanë arrijnë suksese më të dobëta në krahasim me ata të cilët nuk përdorin marihuanë. Përdoruesit e marihuanës më shpesh i adaptojnë sjelljet devijuese, më shpesh jepen pas sjelljeve delikuede dhe agresionit, më tepër protestojnë (rebelohen), kanë marrëdhënie të këqija me prindër dhe më tepër shoqërohen me delikuentë dhe konsumues të substancave narkotike. Hulumtimet tregojnë gjithashtu edhe hidhërim më të madh dhe sjellje re-

gresive, inatosje, mlllef dhe zemërim më të madh, te fëmijët e vegjël, prindërit e të cilëve përdorin marihuanë, krahasuar me fëmijët, prindërit e të cilëve nuk përdorin këtë substancë.

Ndikimi i marihuanës në shtatzëni

Përdorimi i çfarëdo substance narkotike mund të dëmtojë shëndetin e femrës gjatë shtatzënisë. Testet kanë treguar gjithashtu se marihuana mund të jetë shkaktare e çrregullimeve të ciklit menstrual dhe mund të ulë plleshmërinë (fertilitetin) të dy gjinitë. Nëse droga merret gjatë shtatzënisë ajo shkakton lindje të parakohshme. Hulumtimet tregojnë se foshnjat e lindura nga nënat që gjatë shtatzënisë kanë përdorur marihuanë kanë qenë me të vogla sesa foshnjat, të cilat janë lindur nga nënat që nuk e kanë përdorur këtë substancë. Në esencë ekziston mundësia më e madhe që te foshnjat më të vogla të shkaktohen probleme shëndetësore. Lehonat, të cilat marrin marihuanë, nëpërmjet qumështit bartin një sasi të caktuar të THC-së edhe te foshnjat. Hulumtimet kanë treguar se te nënat të cilat kanë konsumuar marihuanë, në muajin e parë gjatë ushqimit të fëmijës nëpërmjet gjirit, mund të shkaktohet dobësimi i zhvillimit motorik të foshnjës (zvogëlimi i kontrollimit të lëvizjes së muskujve).

Ndikimi i marihuanës në sistemin imunologjik

Në lidhje me paraqitjen e qelizave të kancerit në trupin e konsumuesit të marihuanës janë edhe disa studime, të cilat merren me ndikimin e saj në funksionimin e sistemit imunologjik të njeriut. Raportet theksojnë se ekzistojnë disa çrregullime serioze të sistemit imunologjik dhe si pasojë me siguri janë edhe alergjitë e ndryshme që paraqiten te konsumuesit e marihuanës.



Potencialet adiktive të marihuanës

Substanca narkotike është adiktive³² nëse krijon kërkesë kompulsive³³ shpesh të pakontrolluar për të, kërkesë dhe përdorim për të konsumuar pa marrë parasysh pasojat negative shëndetësore dhe shoqërore (sociale). Marihuana plotëson këto kritere që do të thotë konsumuesit për një kohë të shkurtër shndërrohen në varës të drogës. Krizat e abstenimit përcillen me të djersitura, mundime dhe shtangim të muskujve si dhe nervozë të pakontrolluar. Në SHBA mbi 350.000 persona brenda vitit lajmërohen për shërim për shkak të varësisë nga marihuana. Për më tepër, humtimet e bëra në kafshë tregojnë se marihuana krijon varësi fizike, kurse disa njerëz flasin për simptome të shërimit nga abstenimi apo ndërprerja e marrjes së marihuanës.

Shenjat e abuzimit

Përdoruesi mund të bëhet defansiv ose agresiv nëse pyetet se a është përdorues i substancës narkotike. Shenjë tjetër e abuzimit është edhe kundërmimi; tymi i marihuanës ka një erë të qartë, e cila ngelet në flokët dhe rrobat e atij që e përdor. Gjithashtu, në rroba mund të shfaqen vende të djegura si rezultat i rënies së copëzave të kanabisit nga cigarja.

Aplikimi i kanabisit në mjekësi

Në shek. 19 në shtetet e Evropës Perëndimore kanabisi ka qenë ilaç i pranuar. Është përdorur si mjet i përgjithshëm për qetësim, kundër dhimbjeve dhe ngërçeve, për mjekimin e epilepsisë, amenoësë (mungesa e menstruacioneve te femrat të cila nuk janë shtatzënë), për qetësimin e kollës e posaçërisht si ilaç për shërimin e migrenës.

Në fillim të shek. 20 aplikimi terapeutik i kanabisit, dalëngadalë braktiset, më së shumti për shkak të pabarazisë fiziologjike të forcës së drogës, si pasojë e mostretjes së rrëshirës (dyllit) e cila përmban substancat vepruese, si dhe përdorimit gjithnjë e më të madh të morfinës, aspirinës dhe barbiturateve. Kështu, mjekësia shkencore ka hequr dorë nga përdorimi i kësaj substance; në vitet e '40-ta të shek. 20 kanabisi është hequr nga farmakologjia e shumë shteteve.

Në kohërat më të reja, në disa shtete (si Holandë,³⁴ Kanada etj.) përsëri janë duke u liberalizuar ligjet dhe lejohet përdorimi i kanabisit në situata të caktuara mjekësore, posaçërisht si ilaç për shërimin e glaukomës,³⁵ sepse kanabisi e zvogëlon presionin në nervat e syve dhe me këtë e zvogëlon verbërinë, gjithashtu përdoret me citostatikët të mjekimit të kancerit. Janë duke u bërë hulumtime dhe sinteza të lidhjeve të reja të ngjashme me ato të THC- së, në përpjekje të zbulimit të ilaçeve të reja më aktive. Kështu në vitin 1981 në Kanada, për të sëmurët nga kanceri është lejuar përdorimi i substancës, ilaçit sintetik *nabilon*, me molekulë të ngjashme me THC-në; në Britaninë e Madhe janë duke u bërë hulumtime të shumta, sepse është hetuar se THC-ja mund të ndihmojë të të sëmurët nga skleroza multiple.

32 Adiksioni - dëshira e madhe apo nevoja e pashmangshme që substanca narkotike të sigurohet me çfarëdo kushti

33 Kompulsiviteti - paraqet tendencën për të kryer dhe përsëritur veprime të caktuara të cilat përjetohen si detyrime të brendshme dhe nëse nuk plotësohen këto detyrime personi "pushtohet" nga sulmi i ankthit.

34 Përdorimi rekreativ në kafenetë (coffee shops) në Holandë është legalizuar që nga viti 1976.

35 Sëmundje e syrit e përcjellë me dhimbje akute.

Disa fjalë rreth fushatave për legalizimin e marihuanës

Viteve të fundit po zhvillohen polemika të ndryshme rreth çështjes së legalizimit të marihuanës. Në vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore është shkuar në skajshmëri, në satanizimin e marihuanës si e keqja më e madhe e të rinjve, ajo është konsideruar shkaktare e dhunës, dhunimeve dhe vrasjeve, deliriumit dhe çmendurisë. Mirëpo, dihet se nuk është krejt ashtu. Përkundrazi, agresivitetin e shkaktojnë disa ilaçe nga grupi i amfetamineve, të cilat në atë kohë, pra, para Luftës së Dytë Botërore, kanë qenë në shitje legale. Është fakt i vërtetuar se marihuana nuk shkakton kurrfarë agresiviteti, e as delirium intensiv apo ndryshime të befasishme.



Nëse marihuana nuk konsumohet për një kohë të gjatë dhe shpesh, nuk është e domosdoshme të shkaktohen ndryshime të theksuara fizike, psikike apo edhe të shkaktohet varësia prej saj. Mirëpo, ajo që është e pakontestueshme dhe e padiskutueshme, e që është rezultat i konsumimit të marihuanës është - *mënyra specifike e të menduarit dhe funksionimit, që në mënyrë esenciale dallon nga ai konvencional (i përditshëm, normal)*. Është pra një motiv krejtësisht tjetër, që dallon nga ai i përditshmi, i cili qëndron në kërkimin e rrethit të vet, shoqërisë së vet, e cila e kupton dhe ka mirëkuptim për të gjitha veprimet e tij, mënyra e komunikimit, e cila është në një nivel tjetër (të ndryshëm), të prestigjit tjetër, tipit tjetër të argëtimit, shkurt të mënyrës dhe të filozofisë tjetër të jetës. Ajo “shoqëri” e tij, zakonisht ka emërtimin e përbashkët, e ai qëndron në prirje vetëm për argëtim, për jetë pa brenga (të lehtë, të pakujdesshme) dhe pa kurrfarë përgjegjësie për asgjë. Idhujt e tyre nuk janë nxënësit e mirë (sepse për ta është vështirë të “nxehet” karrigia për orë të tëra), sportistët e mirë (sepse është vështirë të ushtrojnë për çdo ditë) dhe të tjerë, të cilët me punën e tyre të vyeshme dhe të ndershme realizojnë suksese. Padyshim, prirjet negative të përmendura janë të shkaktuara nga konsumimi i marihuanës, e cila gjithnjë e më shumë i nxit dhe i përforcon këto prirje negative. Konsumuesi së shpejti e braktis shkollën apo punën sepse nuk dëshiron të bëhet ‘rob’ i formës së jetës konvencionale (normale, të përditshme), që përfshin të zgjuarit herët në mëngjes dhe punën tetë orë ose më tepër, tipit të familjes tradicionale etj.

Prej viteve '60-të të shekullit të kaluar, me lëvizjen masive të të ashtuquajturve "fëmijët e luleve" (lëvizja e hipikëve), kulti i marihuanës pa ndalur është përhapur nëpër botë. Në mënyrë konstante është rritur dhe vazhdon të rritet edhe presioni për legalizimin e marihuanës. Argumente për këtë paraqiten mjaft, por njëkohësisht gjenden edhe më shumë kundër argumente.

Në favor të legalizimit, ndoshta shënimet më konkrete të publikuara janë ato ku jepen raportet për shfrytëzuesit e marihuanës në Kanada,³⁶ në kohën kur në treg është pakësuar, në mënyrë rapide, oferta e marihuanës dhe si pasojë ka qenë kalimi në mënyrë masive të përdorimit të LSD-së, në njërën nga drogat më halucinogjene. Pasojat, padyshim, kanë qenë edhe më të mëdha.

Në anën tjetër, nëse merret në konsideratë fakti i pamohueshëm se marihuana, me të vërtetë e dëmton trurin dhe krijon botëkuptime të kundërta me trendet e përgjithshme botërore kah progresi i profesionalizmit, ekspansionit të madh të teknikës, teknologjisë dhe informatikës – **legalizimi nuk është i mirë.**

Shtimi i konsumuesve të drogës e ngadalëson çdo progres të secilës bashkësi shoqërore. Personi që krijon varësi nga droga nuk mund të jetë ekspert i mirë, as punëtor kualitativ, këto cilësi pozitive nuk mund t'i këtë asnjë konsumues, qoftë i marihuanës, opiumit apo i drogave të tjera.

Është me rëndësi pohimi i kriminologut amerikan, Maibl Eliotit: *"Përdorimi i marihuanës ndoshta është më i rrezikshëm nga konsumimi i drogave të tjera, sa i përket veprimit të saj në sjellje. Duket se marihuana krijon degradim moral dhe shpirtëror më shumë se çdo drogë tjetër. Me përdorimin legal të saj do të zhduket çdo kontroll dhe frenim mbi veten, kurse aftësia mendore haptazi do të shkatërrohet."*

Mendimet për këtë, megjithatë, janë të ndara. Ndarja në droga legale dhe ilegale shkakton huti dhe çrregullim. Përdorimin legal të alkoolit dhe duhanit, por edhe të ilaçeve legale të cilat përdoren për shërim në njërën anë dhe ndalimin e përdorimit legal të marihuanës në anën tjetër, shumica sot e konsiderojnë hipokrizi shoqërore (shtetërore). I shpeshtë është edhe mendimi se kufiri në mes të drogave legale dhe atyre ilegale është i papranueshëm dhe thuhet se duhet të legalizohet përdorimi i të gjitha drogave apo të gjitha të ndalohen. Mirëpo, është i pamohueshëm fakti se me legalizimin e marihuanës (e edhe të drogave të tjera) do të shtohet numri i përdoruesve që do të kishte pasoja të paparashikueshme për të gjitha vendet në botë. Shembulli më i mirë është alkooli dhe duhani, të cilat janë drogat më të përhapura në botë, mu për shkak të përdorimit të lirë. Për legalizimin e marihuanës narko-marketingu është duke luftuar me të gjitha forcat me vite të tëra dhe me anë të programeve të ndryshme tenton t'ia krijojë opinionit publik bindjen se përdorimi i marihuanës është i padëmshëm. Të gjithëve u është e njohur se me legalizimin e marihuanës do të hapeshin me të madhe dyert edhe për përdorimin e të gjitha drogave të tjera, me çka do të shtohej shumë numri i varësve.

Dihet mirë se "jointi" (xhointi) i parë, në shumicën e rasteve, është hapi i parë në botën e substancave narkotike të llojllojshme. Për këtë arsye as që duhet të mendohet për ndonjë legalizim të marihuanës, përkundrazi vetëm duhet të intensifikohet lufta kundër përdorimit të çfarëdo lloji të substancave narkotike.

36 Akti federal i *Canabisit* hyri në fuqi më 17 tetor 2018 dhe e bëri Kanadanë vendin e dytë në botë, pas Uruguait, që legalizoi zyrtarisht kultivimin, mbajtjen, blerjen dhe konsumimin e kanabisit dhe nënprodukteve të tij. Kanada është kombi i parë G7 dhe G20 që e bëri këtë. Kultivimi, shpërndarja dhe ruajtja e kanabisit është ekskluzivisht nën kontroll të qeverisë. Nga 1 korriku i vitit 2019 kanabisi tërësisht është legalizuar.

HASHASHI

Hashashi (hash, shit, fekale) kryesisht është vetëm ndarje mekanike prej rrëshirës (dyllit) të bimës së kanabisit dhe është dhjetë herë më i fortë se marihuana, por kjo varet edhe nga kualiteti. Hashashi i kultivuar në mënyrë artificiale me ndihmën e dritave halogjene mund të jetë më i fortë (më cilësor) se hashashi i cili është i kultivuar në mënyrë natyrore.

Hashashi mund të ketë ngjyrë të verdhë, gështenje apo të zezë. Për prodhimin e një kilogrami të hashashit nevojiten 6 kilogram marihuanë. Hashashi më i mirë dhe më i shtrenjtë është hashashi i Nepalit (*momia apo churus*). Hashashi shitet në formë topthi, pllakave apo në forma të ndryshme të pogaçes.



Hashashi ka shumë emra të tjerë, por jo edhe sa marihuana. Zakonisht emrat me të njohur janë: *Afganistanezi* (në pllakë), i cili ka ngjyrë gështenje apo të zezë. *Kafuri* me prejardhje nga Afrika Veriore, i cili është në formë të shkopit, pastaj i ashtuquajtur *Turku i gjelbër*, i cili është me prejardhje nga Turqia, etj. Hashashi mund të jetë edhe në formë të tabletave. Pihet ashtu si marihuana, i përzier me duhan, apo me opium, apo së bashku me duhan dhe opium. Hashashi mund të pihet edhe i përzier me alkool.

VAJI I HASHASHIT

Vaji i Hashashit (Bhanga) është produkti më i fortë që prodhohet nga Cannabisi, tri deri katër herë më i fortë se hashashi. Në hapësirat tona është vështirë të gjendet. Për herë të parë ka filluar ta prodhojë sekti amerikan religjioz "Vëllazëria e dashurisë së përhershme" aty rreth vitit 1970.

Prodhohet me kullimin e nxehtë dhe filtrimin e rrëshirës së kanabisit, me përpunim plotësues duke iu shtuar aceton, eter dhe tretës të tjerë. Në këtë mënyrë fitohet vaj i errët, i dendur, i cili ruhet në enë të vogla prej qelqi. Përdoret duke e pirë me cigare. Një pikë apo dy qiten në cigare apo në mbështjellësin e cigares.



SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË KANABISIT

(Marihuana, Hashashi dhe Vaji i Hashashit)

SIMPTOMET:

- Zgjerimi i bebëzave të syrit
- Sytë e “përgjakur”
- Verbalizëm (Llafazanëri)
- Gjendja e përgjithshme e njëjtë me të dehurit e lehtë
- Nervozë
- Ndryshimi i ngjyrës së zërit.

PASOJAT:

- Ulja (rënia) e përgjegjësisë
- Humbja e motivit për obligime
- Harresa
- Rritja e prirjes për argëtim
- Arroganca në komunikimin me prindër
- Rreziku në komunikacion, trafik,
- Rritja e rrezikut të kalojë në droga më të rrezikshme.

SHENJAT E PËRDORIMIT:

- Era e rëndë e djegies së fletës apo rrënjës (“era duman”)
- Farat e imta nëpër xhepa
- Letrat për mbështjelljen e duhanit (cigareve)
- Të skuqurit nën sy (të ashtuquajturit jastëkët).

LSD–ja (Lizergjidi apo dietilamidi i thartirës Lizergjine)

LSD–ja (Lizergjidi apo dietilamidi i thartirës Lizergjine) nuk është derivat natyror, është një drogë gjysmë-sintetike e prodhuar nga acidi lisergjik i cili në formë të kërpudhës së vogël jeton si parazit në kokë të thekrës (*Claviceps purpurea*) dhe drithëra të tjera.



Niveli i përhershëm i këtij paraziti quhet sklercijum, kurse pjesa përbërëse e tij është thartira lizergjine e cila në bazë të përbërjes farmakologjike të saj është e ngjashme me adrenalinin, meskalinin dhe amfetaminin. Njihet me emrat trip, acid, haze, letër apo fotografi. LSD-ja bënë pjesë në grupin e drogave halucinogjene me veprim shumë të madh te njeriu, është 100 herë me e fortë se kokaina apo pejotla. Është në listë nën klasën A të substancave narkotike të ndaluara.

LSD-në e ka zbuluar Dr Albert Hoffmani në vitin 1938 dhe konsiderohet një nga substancat më të forta për përjetimin e perceptimeve. Është pluhur i bardhë, pa erë, zakonisht pihet në formë të lëngët në të cilin vihen letra të vogla (në formë të fotografive të vogla në madhësi si të pullave postare me ngjyra të llojllojshme). Gjatë viteve `50 dhe `60 është përdorur në mënyrë legale në formë eksperimentale (kryesisht në psikiatri) për mjekimin e problemeve psikike dhe alkoolizmit, mirëpo është ndërprerë për shkak të sulmeve të shpeshta të panikut, paranojës dhe përgjithësisht tronditjeve mendore.

Bazat

LSD-ja është njëra nga substancat halucinogjene më të përdorura. Konsumohet në formë orale, mirëpo sot në masë të madhe përdoret në formë të letrave të vogla dekorative, që kryesisht kanë formë të katrorëve të terur, të cilat më parë janë lyer (të absorbuar) me LSD të lëngët. Format e tjera, të cilat janë më të rralla, si tabletat shumë të vogla (të njohura si "Microdots"), pastaj letra xhelatinoze dhe kubëzat e sheqerit. Katrorët e vegjël të absorbuar në LSD të lëngët, janë forma më e përhapur për arsye se prodhohen dhe fshihen lehtë dhe lënë pak mundësi të absorbohen në lëngun, i cili nuk është i LSD-së.

Dozimi

Doza standarde e LSD-së në 20 vjetët e fundit është në mes të 50 dhe 150 mikrogramëve³⁷ që LSD-në e bën njërën nga substancat më të forta psikoaktive, të njohura deri në ditët e sotme, për shkak të veprimit në doza shumë të vogla, por me efekte jashtëzakonisht të forta.



Efektet

Fillimi i veprimit të LSD-së është 20-60 minuta pas marrjes. Varet prej konsumuesit se a ka marrë ushqim para se të përdorë drogën apo jo, kështu që fillimi i veprimit mund të vazhdohet deri në dy orë. Problemi më i shpeshtë është se konsumuesi mendon se doza të cilën e ka marrë nuk është mjaft e fortë dhe e rrit dozën, Edhe pse LSD-ja nuk mund të shkaktojë varësi fizike, ajo mund të shkaktojë varësi psikike. Pas disa ditësh përdorimi të rregullt, individ i fillon të bëhet tolerant ndaj veprimit të LSD-së. Veprimi i LSD-së zgjat 8 deri 16 orë, prej kësaj gjysma e kohës janë halucinacione. Për shkak se ka një kohëzgjatje të madhe të veprimit, është shumë vështirë të fshihet konsumimi dhe në mënyrë normale të vijohet mësimi apo puna. Efektet e para të veprimit zakonisht përcillen me marrje mendsh, ndjenjë të të ftohtit, të dridhura dhe një dëshirë e pakontrolluar për të qeshur.

Pastaj rritet ndjeshmëria ndaj dritës, ndjenja ose perceptimi se sendet janë në një formë tjetër e jo si janë në realitet. Sa më të fuqishme që bëhen efektet, paraqitet një spektër i madh i ndryshimeve perceptuese, stimulimi fizik dhe mental, zgjerimi i bebëzave, efektet vizuale halucinogjene me sy të hapur apo të mbyllur, ndryshimi i rrjedhës së vetëdijes dhe të menduarit, ndjenja e njohurive (shikimit apo njoftimit) në “diçka më të lartë” nga gjendja e thjeshtë apo “normale” e vetëdijes, konfuzioni, paranoja, dhe ndërrimi i shpejtë i emocioneve (frika, hidhërimi, gëzimi, hareja etj.).

Në këtë gjendje konsumuesi mund të provojë eksperiencë mitike apo pseudo-religjioze. Nëse vuan nga ankthi apo depresioni mund të ketë humbje të kontrollit emocional, halucinacione të pakëndshme apo të tmerrshme, ndjenjë të lartë ankthi, dëshpërimi dhe paniku. Sa më shumë dhe sa më gjatë të përdoret LSD-ja, aq më shumë rriten shanset për shqetësime mendore, duke përfshirë depresionin e rëndë të individëve me probleme ekzistuese psikike.

³⁷ Pjesa e njëmijtë e miligramit

Nuk është regjistruar asnjë rast i vdekjes i lidhur drejtpërdrejt me helmim nga LSD-ja. Por, janë të njohura shumë raste të vetëvrasjeve të shkaktuara drejtpërdrejt nga psikozat dhe halucionacionet si pasojë e përdorimit të LSD-së. Gjithashtu, janë të njohura shumë raste ku personat nën ndikimin e kësaj droge janë hedhur nga ndërtesat apo urat e larta dhe kanë përfunduar me fatalitet, duke besuar se janë zogj dhe mund të fluturojnë. Duhet theksuar se te LSD-ja janë të shpeshtë edhe të ashtuquajturit *flashbacks*³⁸. Flashbacks – u mund të ndodhë pas disa ditëve, por edhe pas disa javëve apo muajve.

SIMPTOMAT, PASOJAT DHE SHENJAT E PËRDORIMIT TË LSD-së

SIMPTOMAT E PËRGJITHSHME

- Sjellje e çuditshme
- Gjendje konfuze
- Janë të mundura halucionacionet (gjendjet mund të jenë të ngjashme me psikozat dhe çmenduritë)
- Zgjerimi i bebëzave të syrit
- Puls i rritur
- Komunikimi i vështirësuar
- Të folurit jo sistematik (pa lidhje).

PASOJAT:

- Rritja e rrezikut nga psikozat
- Dëmtimi i funksionit të trurit
- Paranoja
- Paniku
- Të ftohurit e trupit
- Rritja e rrezikut nga pësimi i fatkeqësive
- Prirja për marrjen e drogave të tjera
- Flashbacks (halucinacione të mëvonshme).

SHENJAT E PËRDORIMIT:

- Kubëzat e sheqerit të ngjyrosura, fletëzat e vogla të letrës me vizatime të ndryshme
- Kapsula xhelatini
- Era e fortë (e rëndë) e trupit.

38 Kthim mbrapa - këtu e ka kuptimin në ndjenjat të cilat përjetohej më vonë.

PCP – ja, apo pluhuri i engjëllit (Fenciklidini, në bazë të formulës fenilciklohek silpiperidin)

Substanca halucinogjene e njohur me emrin e shkurtër PCP-ja, Fenciklidini (në bazë të strukturës kimike është fenilcikloheksilpiperidin), është pluhur i bardhë kristali i cili në fillim të viteve '60 të shekullit 20, kompania amerikane Parke-Devis & Co e ka lëshuar në qarkullim si mjet kundër dhimbjeve dhe si anestetik lokal gjatë operacioneve të lehta. Mirëpo është treguar se në dozat prej 10 miligramëve, PCP-ja, pos veprimit analgjetik dhe anestetik, shkakton halucinacione, gjendjen psikike të të "qëndruarit pezull apo në fluturim jashtë trupit", gjendje të skizofrenisë, deliriumit dhe depresionit të Sistemit nervor qendror. Është vërtetuar edhe veprimi *teratogjen*³⁹ (malformacioni i trashëgimit) i kësaj droge.

Përdorimi i PCP-së ka filluar të përhapet, së pari në mesin e hipikëve të Kalifornisë, ku kjo drogë është quajtur "pluhur i engjëllit". Ndërkohë, kjo substancë narkotike shumë shpejt është gjetur në mesin e konsumuesve të substancave narkotike të Nju Jorkut.



Pas ndalimit të përdorimit të PCP-së në mjekësi dhe tërheqjes së tij si ilaç nga qarkullimi në treg (1965), në tërë territorin e SHBA-së u krijuan shumë laboratorë ilegalë për prodhimin e PCP-së.

³⁹ Teratogjeni: Çdo element që mund të çrregullojë zhvillimin e embrionit ose fetusit. Teratogjenët mund të shkaktojnë një defekt të lindjes tek fëmija. Ose një teratogjen mund të ndalë shtatzëninë plotësisht. Klasat e teratogjenëve përfshijnë rrezatimin, infeksionet amënore (të nënave), kimikatat dhe ilaçet.

Mirëpo këta laboratorë kanë prodhuar PCP-në e papastër dhe pikërisht për shkak të mospastrimit toksik, në shumë raste ka shkaktuar komë dhe vdekje. Në fillim të viteve '70 shumë shpejt nëpër rrugët e qyteteve të SHBA-së është përhapur me të madhe shitja e kësaj droge. Prodhimi ka qenë kryesisht në formë të kapsulave, të cilat kanë pasur përzierje me drogat e tjera si me: amfetaminë, kokainë, heroinë, meskalinë, marihuanë apo LSD dhe për këtë shkak ato kapsula shpesh në rrugë janë shitur me emra të këtyre substancave shtesë.

PCP-ja merret në shumë forma: thithet me hundë (ngjashëm me kokainën dhe heroinën), përtypet si tabletë apo me anë të spërkatjes të PCP-së (në duhan apo marihuanë qiten disa pika të PCP-së). Veprimi më i shpejtë është kur të merret në gjendje të lëngët, në formë të injektimit.

Vlerësohet se deri në fund të viteve '70, PCP-në e kanë provuar mbi pesë milionë amerikanë, madje shumica të moshës 12-25 vjeç. Gjatë këtyre vjetëve janë regjistruar mbi dyqind raste të vdekjes nga "pluhuri i engjëllit". Konsumuesit nën ndikimin e kësaj substance kanë kërcyer nga kulmet e shtëpive, të tjerët kanë përjetuar halucinacione ndër më të tmerrshmet. Edhe pirja pasive e cigareve të stërpikura apo me spërkatje të PCP-së është gjithashtu e rrezikshme. Në vitin 1981 në një spital të Kalifornisë janë mjekuar dhjetëra fëmijë (në mes të moshës tetëmuajshe dhe pesëvjeçare) të cilët kanë qenë të intoksikuar duke qëndruar në të njëjtën hapësirë (dhomë) ku janë pirë cigare, të cilat më parë kanë qenë të stërpikura me lëngun e PCP-së. Disa hulumtime më të reja tregojnë se PCP-ja kalon prej nënës (shtatzënë) në fryt, kjo pasi që metabolizmi i drogave është shumë i ngadalshëm dhe ekziston mundësia që nëna ta përcjellë drogën te fëmija edhe nëse e ka konsumuar atë para fekondimit.

Ndër shkaqet e përhapjes shumë të shpejtë të PCP-së ka qenë çmimi i ultë i blerjes. Sintetizimi i kësaj droge (për dallim nga LSD-ja) ka qenë shumë më i thjeshtë dhe më i lirë. Këto janë arsyet pse kjo drogë ka qenë shumë më e pranueshme se LSD-ja apo heroina. Shkaku kryesor i popullaritetit të kësaj droge ka qenë në faktin se ajo ka vepruar shpejt dhe me intensitet të lartë. Mirëpo si edhe te drogat e tjera, veprimi i saj varet nga lloji i drogës së konsumuar, mënyra e marrjes dhe nga konstitucioni psikofizik i varësit (konsumuesit).

STP-ja



STP-ja është substancë gjit-hashtu halucinogjene, të cilën në vitin 1964, me qëllim të përdorimit në psikiatri, e ka sintetizuar kimisti amerikan **Alexander Shulgin**, në bazë të strukturës 4-metal - 2,5 - dimetok - simetilamin dhe në pikëpamje kimike është e lidhur me meskalinën dhe amfetaminën. STP-ja nuk është shenja kimike (sikur që është rasti me LSD-në apo PCP-në) por është anakronim prej "Serenty, Tranquility, Peace" (Këthjelltësi, Qetësi, Paqe).

Ky preparat është paraqitur në tregun ilegal kah fundi i viteve '60 dhe me shpejtësi ka marrë epitetin e "bombës hidrogjenike" kur është krahasuar me LSD- në (si bombë atomike).

Efektet e STP-së janë në kontinuitet të vazhdueshëm dhe mund të kthehen edhe pas ndërprerjes së konsumimit të saj, në kohën kur individ i intoksikuar ndihet gati si i shëruar. Kjo është një ndër substancat më helmuese halucinogjene. Ndodh që personi i intoksikuar të përjetojë disa ditë radhazi halucinacione të tmerrshme, të cilat e rraskapitin tërësisht, ku janë të njohura edhe rastet e paralizës së rëndë. Mjekimi i intoksikimit prej STP-së nuk është i mundur me klorpromazinë,⁴⁰ siç është rasti me LSD-në. Nuk është i njohur niveli i dozës së saktë të kësaj droge me të cilën do të shkaktohen efektet (euforitë) e dëshiruara (veprimi i efekteve të STP-së në njerëz nuk është hulumtuar asnjëherë në mënyrë shkencore), por mendohet se sillet prej 3-8 miligramë.

Kjo substancë narkotike me të madhe ka filluar të konsumohet në një lagje hipikësh të San Franciskos me rastin e festimit të solstikut.⁴¹ Gjatë një dite janë shpërndarë afro 500 tableta të STP-së. Shumica që e kanë përdorur këtë drogë nuk i kanë parashikuar veprimet e saj. Pas tri ditësh shumica kanë qenë edhe më tutje në 'trip'⁴² (high) nën ndikim të drogës, kurse spitalet në San Francisko kanë qenë të stërmbyshura me hipikë të cilët kanë menduar se më asnjëherë nuk do t'i kthehen jetës normale pas tmerreve që kanë përjetuar nga efektet e kësaj droge.

40 Antipsikotik me të cilin mjekohen (zvogëlohen) simptomat psikotike siç janë: halucinacionet, idetë e sëmura dhe të menduarit jo logjik të sëmundja e skizofrenisë.

41 Festimi i ditës më të gjatë të vitit, duke llogaritur nga lindja e diellit e deri në perëndim të diellit.

42 Zhargone për gjendjen nën ndikimin e substancave narkotike, gjendje e euforisë së fortë e ngjashme me komën.

IBOGANI



Është substancë narkotike, e cila gjendet në numrin një të drogave të ndaluara në shumicën e vendeve në botë. Ky është një halucinogjen i fuqishëm, i cili në trurin e njeriut vepron dhe shkakton vizione të bujshme dhe efekte të fuqishme psikoaktive. Ibogaini është alkaloid indolik, i cili është izoluar nga bima *Tabernanthe iboga*, që rritet në malet me plot lagështi të Gabonit dhe Zairesë. Banorët

e fisit Bwit, me qindra vjet i përdorin si stimulues rrënjët e kësaj bime, të përziera me lëvore dhe fletë të ndryshme. Gjithashtu, e përdorin si mjet rezistues me rastin e gjuetisë dhe të ritualeve të gjata religjioze rraskapitëse.

Ibogaini me vështirësi të mëdha mund të prodhohet në laboratorë, edhe kur të prodhohet ibogaini artificial nuk i ka efektet e njëjta si ai që prodhohet prej rrënjëve të asaj bime. Te dozat e mëdha ibogaini shkakton tronditje, konfuzion mental dhe halucinacione të fuqishme. Për një dozë të mesme prej 650 deri 750 miligramë janë të nevojshme 9 kilogram të rrënjëve të ibogainit. Për nga efektet është i ngjashëm me LSD-në. Duket se nuk shkakton varësi fizike.



KËPURDHAT– Kërpudhat e shenjtë (Magic mushrooms)

Në natyrë ekziston një numër i madh i llojeve të kërpudhave të ndryshme, të cilat radhitën me emrin e përbashkët shumë të popullarizuar “magic mushrooms”. Të gjitha llojet mund të ndahen në tri grupe kryesore: *Psilocibe*, *Panaeoluse* dhe *Copelandia* (këtu nuk hyjnë kërpudhat e grupit *Amanita*). Karakteristikat kryesore të të gjitha këtyre kërpudhave janë se kanë substanca psikoaktive,⁴³ të cilat përdoren me shekuj në kultura të ndryshme me rastin e riteve të ndryshme religjioze. Veprimi i tyre mund të krahasohet me veprimin e LSD-së d.m.th. janë të ngjashme me LSD-në. Konsumimi i kërpudhave psilocibine shkakton ndryshime psikike, vizuale dhe perceptuale. Këto kërpudha zakonisht janë të vogla me ngjyrë gështenje apo të gjelbra; vjelësi joprofesional mund të hutohet dhe shumë lehtë mund t’i zëvendësojë me ndonjë kërpudhë tjetër, e cila mund të jetë helmuese për vdekje.

E vetmja karakteristikë e hetuar për kërpudhat psilocibike është se ajo menjëherë pasi të vilet shumë shpejt e ndërron ngjyrën dhe merr ngjyrë të kaltër të mbyllur.

Për shkak të rëndësisë minore që kanë në hapësirën ballkanike do të përmendim vetëm ato më të rëndësishme, si dhe cilësitë e tyre karakteristike. Ndër kërpudhat më të njohura janë: ***Psilocibis mexicana***, ***Psilocibis cubensis***, ***Kaktusi Pejtol (meskalina)*** dhe ***Amanita muscaria (muskardini)***.



43 Substanca psikoaktive (psikofarmaceutike, psikodelike ose psikotrope) është një substancë kimike që ndryshon funksionin e sistemit nervor dhe rezulton me ndryshime në perceptim, gjendjen shpirtërore, vetëdijen, njohjen ose sjelljen.

Veprimi i këtyre dy alkaloidëve edhe më tutje është mjaft i paqartë. Në formë të hipotezës është e pranuar teoria se veprimi i psilocibinit dhe psilocinit është i njëjtë si i LSD-25. Përbërësit kryesorë psikoaktivë të këtyre kërpudhave janë alkaloidët *psilocibini*, *psilocini* dhe *beocistini* (te disa edhe *norbecistini*).



Kërpudhat e shenjta apo *magic mushrooms* paraqiten shumë rrallë në tregun ilegal të shteteve ballkanike për shkak të çmimit shumë të lartë dhe dyshimit në cilësinë e tyre. Për shkak të vështirësive të mbrojtjes dhe transportit, pastaj për shkak të përdorimit joprofesional (mosnjohja e mënyrës së kultivimit dhe cilësive të tyre specifike) substancat e tyre humbin në cilësi. Atëherë veprimet e drogës nuk janë të mjaftueshme për t'i arritur efektet e pritura. Pos kësaj është e mundur që lëndët apo bimët, të cilat konsiderohen se janë kërpudha e në të vërtetë të mos jenë kërpudha, por të jenë kaktuse apo bimë të tjera narkotike.

PSILOCIBINI

Psilocibini është alkaloid⁴⁴ me bërthamë indolike, i vetmi halucinogjen, i cili në molekulën e tij përmban atomin e fosforit.

Psilocibini është halucinogjen që gjendet në një numër të madh të kërpudhave, posaçërisht nga familja *Psilocibe*. Në kultura të caktuara primitive këto kërpudha janë përdorur për qëllime mistike-religjioze. Rasti më i njohur është përdorimi i tyre në mesin e actekëve, “banorët e parë të Meksikës”. Fjala është për kërpudhën *Psilocibe mexicana*, të cilën vendësit e thërrasin “teonanekat” që do të thotë *mishi i Zotit* apo *ushqim i Zotit*.



Është me ngjyrë të gjelbër të mbyllur me erë shumë të pakëndshme, e cila i përngjan yndyrës së tejdjegur. Është bimë e vogël dhe më së shumti rritet në Meksikë. Me shekuj është përdorur në ritet religjioze të indianëve të Meksikës dhe SHBA-ve (të vendosur kryesisht në luginën e lumit Rio Grande).

⁴⁴ **Alkaloidët** janë produkte natyrore me përbërje të caktuar, të cilët përveç karbonit, hidrogjenit dhe oksigjenit, gjithmonë përmbajnë edhe azot. Deri më tani janë izoluar dhe është përcaktuar struktura e mbi 6000 alkaloidëve. Në doza të larta alkaloidët janë helmues për njeriun, por në sasi të vogla reagojnë vlefshëm për organet e ndryshme.

Në bazë të disa autorëve edhe viktimat në njerëz, të cilat janë shkaktuar me rastin e riteve religjioze (të cilat nganjëherë kanë qenë të përgjakura dhe me pasoja tragjike), janë bërë nën ndikimin e këtyre kërpudhave. Në doza të mëdha ato mund të stimulojnë dëshirën për vetëvrasje, me çka sqarohet se viktimat në ritualet religjioze kanë qenë nën ndikimin e këtyre kërpudhave.

Në tregun ilegal shiten si kërpudha të thata. Përdoret me përtyppje të ngadalshme. Substanca kryesore e kësaj bime, Psilocibini, mund të ndahet dhe të sintetizohet, kështu në shitje në tregun ilegal mund të gjendet në formë kristali të bardhë, pluhuri, tableta, kapsula dhe lëngu të kthjellët (pastër). Efektet e Psilocibinit sintetik janë shumë më të fuqishme se sa efektet e kërpudhave të thata.

Pasojat e përdorimit të kësaj droge janë të shprehura me halucinacione, të cilat zgjasin një kohë të gjatë dhe eufori të fuqishme. Përdorimi për një kohë të gjatë rezulton me një tolerancë dhe varësi psikike. Duket se nuk shkakton varësi fizike.

Sot, këto kërpudha nga familja *Psilocibe*, përdoren edhe në botën perëndimore, si edhe halucinogjenët e tjerë, por për Psilocibinin nuk ekzistojnë shënime të sakta. Psilocibini është substancë me veprim shumë aktiv. Efektet e para duken me dozën prej 4 miligramëve. Simptomat e para fillojnë prej 0,5-2 orë pas marrjes. Efektet më të theksuara negative janë të përcjella me dhembje koke, marrje të mendve, dobësim të muskujve, zvogëlim të pulsit dhe me tension të gjakut, si dhe efekte psikike, të cilat mund të jenë të këndshme, por edhe tejet të pakëndshme. Shfaqet euforia apo depresioni, ndjenja erotike, humbja e koncentritimit, halucinacionet, çrregullimet në të perceptuarit e kohës dhe hapësirës, mirëpo edhe agresiviteti ndaj vetvetes. Veprimi zakonisht zgjat 6-10 orë.

Pasojat negative të konsumit të Psilocibinit:

- Mundimi dhe shqetësimi, brengosja, marramendja, konfuzioni
- Ndjeshmëria e madhe ndaj muzikës, zhurmës dhe shushuritjes
- Paranoja, frika dhe paniku
- Ndikime të padëshirueshme në ndryshimin e jetës për një kohë të gjatë
- Flashbacks⁴⁵
- Mendime dhe vizione të tmerrshme
- Ndryshimi i përgjithshëm i vetëdijes
- Zgjerimi i bebëzave të syve
- Të menduarit dhe të folurit jo të zakonshëm
- Ndryshimet në perceptimin e kohës (koha kalon, rrjedh më ngadalë)
- Rritja e temperaturës së trupit dhe
- Rritja e pulsit.

45 Përsëritja spontane e halucinacioneve vizuale ose efekteve të tjera të një substance narkotike, si LSD dhe halucinogjenët e tjerë, shumë kohë pasi përdorimi i substancës është ndërprerë.

OPIATËT APO OPIOIDËT⁶⁷

(Opiumi, Morfina, Kodeini, Tebaini, Heroini, Oksikodoni, Bubronofina, Fentanilli, Metadaoni dhe Tramadolli)

Opiatet janë substanca psiko-farmokologjike që rrjedhin nga opiumi dhe përdoren si ilaçe, por edhe si substanca narkotike. Opiumi nxirret nga lulëkuqja e opiumit, kurse prej opiumit janë sintetizuar, morfina, kodeina, tebaini dhe të gjithë opioidët tjerë.



Ekzistojnë tre lloje të opiateve:

Opiatet natyrorë (Opiumi, Morfina dhe Kodeina), **gjysmë sintetike** (Heroina, Oksikodoni, Bubrenorfina) dhe **sintetike** (Fentanilli, Metadoni dhe Tramadolli).

Opiatet kanë një efekt të fortë analgjetik dhe qetësues, ato shkaktojnë largimin e dhimbjes, tensionin emocional, ankthin dhe shkaktojnë një disponim të këndshëm. Marrja e tyre shumë shpejt çon në varësi.

Një numër i madh i opiateve përdoren aktualisht në mjekësi (buprenorfinë, kodeina, oksikodoni, metadoni, morfina etj.), veçanërisht të dobishëm janë për kontrollin e dhimbjeve të forta të shkaktuara nga gjendjet e rënda mjekësore, të tilla si kockat e thyera ose dhimbjet pas operacionit, si dhe për kontrollin e dhimbjes që shoqërohet me probleme të rënda mjekësore të fazës fundore,

⁶⁷ Edhe pse termi opiate shpesh përdoret si sinonim i opioideve, kjo nuk është e saktë, pasi opiate quhen vetëm alkaloidet natyrale që prodhohen nga rrëshira e lulëkuqes së opiumit (Papaver somniferum).

veçanërisht të kancerit terminal. Analgjetikët opiatik përdoren gjithashtu drejtpërdrejt, para ose gjatë anestezisë, sepse ato zvogëlojnë nevojën për barna të tjera gjatë anestezisë, ose në doza të mëdha si anestetikë të pavarur në operacionin kardiovaskular.

Në sasi më të mëdha, ato ndikojnë negativisht në përqendrimin dhe koordinimin e lëvizjeve: ngadalësojnë dhe dëmtojnë aftësinë për t'u përgjigjur stimujve dhe mund të çojnë në pavetëdi-je, gjendje kome dhe madje edhe vdekje. Kur përdoren në sasi të mëdha, gjithashtu shkaktojnë varësinë mendore e fizike dhe ato zhvillohen me intensitet më të madh se zakonisht. Për shkak të efektit narkotik, zhvillimit të sjelljes euforike dhe tolerancës, si dhe zhvillimit të varësisë, opiatët janë shumë të rrezikshëm dhe përdoren vetëm kur ekziston një justifikim mjekësor për përdorimin e tyre. Për më tepër, opiatët mund të shkaktojnë probleme edhe tek njerëzit që i marrin ato në mënyrë kronike nën mbikëqyrjen e mjekut. Mirëpo, opiatët në përgjithësi shkaktojnë probleme serioze. Opiatët keqpërdoren në mënyrë masive. Këto ilaçe janë mjaft problematike. Në fakt, varësia nga opiatet me recetë të mjekut dhe opiatet të siguruar në mënyrë e paligjshme (kryesisht heroinë) janë bërë një problem i madh shoqëror. Varësia nga opiatet po shkakton një epidemi të vdekjeve të lidhura me mbi dozën.

OPIUMI – *Papaver somniferum*

(Opiatët natyrorë, Opiumi, Morfina, Kodeini, Tebaina)



Lulëkuqja e opiumit (mak, poppy, papaver, clubs), me emrin latin Papaver Somniferum, është bimë njëvjeçare me trung dhe fletë, me lartësi deri 1.60 m e nganjëherë edhe deri në dy metra. Fletët janë të mëdha, zakonisht me katër petale, me ngjyrë të kuqe apo të bardhë varësisht nga nënlloji. Fshikëza (koka) është e rrumbullakët ose në formë bombole me ngjyrë të kaltër në të gjelbër, të gjelbër të çelur ose të gjelbër të mbyllur. Ekzistojnë disa lloje të Papaver somniferum si: album, glabrum, depressum, setigerum etj. Me prerjen e kokës (fshikëzës) rrjedh (kullon) lëngu i bardhë, i cili merr ngjyrë gështenje. Prej fshikëzës nxirret me anë të thikave të topitura – ky është opiumi i papërpunuar i cili përmban mbi 20 alkaloidë, substanca aktive të cilat kanë veti narkotike, ku përbërësit kryesorë janë: Morfina (3

deri 23%), Kodeina (0.2 deri 2%), Tebaini (0.2 deri 0.5%). etj. Pas tharjes në diell ngjeshet në formë të katrorëve apo në forma të tjera. Gjatë kohës, opiumi i papërpunuar forcohet dhe merr ngjyrë gati të zezë. Mund të ruhet deri në 15 vjet e të mos humb aspak nga kualiteti.

Cilësia e opiumit vlerësohet duke u bazuar në sasinë e alkaloidit të morfinës dhe varet nga klima në të cilën rritet lulëkuqja. Përdoret në mjekësi për shkak të efektit të fortë analgjetik. Për shkak të rreziqeve të varësisë, përdoret rrallë, vetëm për dhimbjet më të forta. Është materiali fillestar për përfitim të opiatëve gjysmë sintetike, kryesisht heroinës.



Opiumi njihet që nga viti 3400 p.e.s. kur lulëkuqja u kultivua në Mesopotami për shkak të efektit të saj dehës dhe hipnotik. Kultivimi i bimës u mor nga asirianët, pastaj babilonasit dhe më pas egjiptianët. Rreth vitit 1300 p.e.s. egjiptianët kultivuan opiumin të cilin e tregtuan me fenikasit dhe e përhapën më tej në Mesdhe, Greqi dhe Kartagjenë. Alek-

sandri i Madh, rreth vitit 330 p.e.s., barti opiumin në Persi dhe Indi. Tregtarët arabë përhapën lulëkuqen e opiumit në Mesdhe, Evropë dhe Kinë. Në të vërtetë opiumi është shfrytëzuar si ilaç në të gjitha vendet e Lindjes, të Azisë dhe të Egjiptit. Rreth viteve 1500 në Turqi ka qenë shprehur ngrënia e opiumit si ushqim, kurse rreth viteve 1600 banorët e Persisë dhe Indisë përvetësuan shprehinë e ngrënies dhe pirjes së një përzierje nga opiumi për t'u freskuar. Në shekullin XVI opiumi ishte pjesë përbërëse e shumë ilaçeve. Mjeku, farmacisti dhe alkimisti Paracelsus bëri pilula të zeza ("gurë pavdekësie") nga *Opium thebaicum* dhe lëngu i limonit si ilaç kundër dhimbjeve. Në farmakologji (1774) opiumi është përshkruar si 'mjet hyjnor'.



Në fillimi të shek. XIX, me zhvillimin e kimisë organike janë hapur dimensione të reja në lidhje me këtë problematikë. Në sajë të këtij përparimi farmacisti gjerman, Serturneri (Friedrich Sertürner 1783-1841) ka arritur, në vitin 1803, ta izolojë nga opiumi thartirën mekanike dhe bazën të cilën e ka quajtur *morfum*, në bazë të zotit të gjumit, Morfeut. Pak më vonë (1817) kimisti francez, Robikeu ka arritur që nga

opiumi të ndajë kodeinën. Opiumi kultivohet dhe prodhohet gati në të gjitha vendet e Mesdheut (duke përfshirë edhe të gjitha viset shqiptare) dhe të Evropës së Mesme.

Emra të huaj për lulëkuqen janë: *Garden Poppy*, *Opium Poppy*, *Withe Poppy*, *Shhlaf-Mohn*, *Gartenmohn*, *Papavero domestico* etj. Opiumi është një ilaç (narkotik) që duke vepruar në sistemin nervor qendror lehtëson dhimbjen (analgjetik), ka një efekt qetësues (qetësues dhe hipnotik), zvogëlon dhe largon dhimbjen, zvogëlon ngërçet (antispasmodikët), shkakton kapsllëkun në rastet e diarresë (antidiarrea-le), deprimon (zvogëlon) pulsën në qendrën e frymëmarrjes, zvogëlon ngacmimin e kollës (antitusik). Shërben gjithashtu edhe si ilaç në mjekësinë veterinare. Në industrinë farmaceutike, opiumi përdoret si lëndë e parë për prodhimin e morfinës, kodeinës, papaverinës dhe opiatëve apo opioidëve.

Konsumimi i opiumit është i mundur në mënyra të ndryshme si: me injektim intravenoz, në mënyrë orale, respiratore dhe nazale. Keqpërdorimi i opiumi të papërpunuar në fillim është përdorur duke e pirë në formë të cigares. Kjo formë e përdorimit nuk është më aktuale te konsumuesit e substancave narkotike. Ka mbetur vetëm përdorimi i tij me çaj. Pas depërtimit të heroinës në hapësirat tona, opiumi praktikisht nuk është më në treg. Varësit e sotëm modernë nuk e dinë më procesin e përgatitjes për injektimin e opiumit, i cili është shumë më i ndërlikuar sesa për heroinën.

Efektet e opiumit janë të ngadalta dhe të ngjashme me heroinën. Përdoruesi zakonisht kalon në tre faza:

- Faza e parë karakterizohet nga një eufori fillestare e fortë, një ndjenjë ngrohtësie dhe rrahje zemre e përshpejtuar.
- Në fazën e dytë, ndodh përgjumja dhe lodhja e këndshme, funksionet mendore ngadalësohen dhe zemra rreh më ngadalë.
- Fazën e tretë e karakterizon gjumi, pas të cilit ndihet një lodhje, mungesë motivimi dhe depresion.

Opiumi shkakton varësi shumë shpejt dhe lë pasoja në sistemin nervor qendror, si dhe në organet e tjera. Pas keqpërdorimit të opiumit për një kohë të gjatë, vërehet depresion i shpeshtë, neglizhencë e jashtme dhe varësi psikologjike.

MORFINA

Shprehja mjekësore *morfein* nënkupton pjesën kryesore aktive të opiumit. Në vitin 1805, përbërësi aktiv i opiumit, morfina, u izolua nga farmacisti gjerman Friedrich Wilhelm Adam Sertürner.

Siç u përmend më lart, emrin e ka marrë në bazë të Zotit të gjumit në Greqinë Antike – Morfeut. Fitohet drejtpërdrejt prej opiumit apo nga bima e hashashit. Nga Lulëkuqja e opiumit sigurohet 1/3 e të gjitha nevojave botërore të morfiumit. Në bazë të disa shënimeve *morfeina* ka filluar të përdoret në vitin 1864 pas zbulimit të shiringës.



Injektimin e parë nën lëkurë e ka provuar në trupin e vet mjeku nga Edinburgu, Wood Alexander, në vitin 1852, i cili njihet edhe si “morfisti” i parë. Një kohë morfiumi është trajtuar si substancë e pandashme (që nuk mund të zbërthehet në substanca të tjera), e për këtë ‘fajtorë’ kanë qenë vetë mjekët. Shënimet flasin se mjekët, qëllimisht e kanë fshehur të vërtetën për opiumin dhe derivatet e tij, për shkak të ‘interesave personale’. Jo zyrtarisht flitet se çdo i dyti mjek ka qenë morfist. Morfina paraqitet si mjet mjaft efikas për zvogëlimin e dhimbjeve. Në treg paraqitet në formë të prizmave dhe të kristaleve, në formë të pluhurit, lëngut apo ampulave. Si substancë është me shije të hidhur dhe pa ngjyrë. Fitohet me rafinimin dhe spastrimin e disahershëm të opiumit të papërpunuar.

Përdoret si analgjetik shumë i rëndësishëm në mjekësi, por edhe si drogë, gjegjësisht substancë narkotike.

Morfina është një pluhur i bardhë kristalor. Është pa erë, por mund të njihet nga shija e saj e mprehtë (në mes të të ihtës dhe të thartës) apo faktit që ajo bëhet e verdhë në dritë. Është e vështirë të tretet në ujë dhe alkool. Morfina krijon shpejt tolerancë, kështu që të varurit që e marrin atë në mënyrë kronike mund të tolerojnë doza që janë 20-200 herë më të larta sesa ato terapeutike. Pavarësisht nga toleranca, ekziston gjithmonë doza vdekjeprurëse. Morfina mund të gjëlltitet, të merret në mënyrë intravenoze, me anë të thithjes dhe përmes ngrohjes. Të varurit nga droga zakonisht marrin atë në mënyrë intravenoze për shkak të fleshit (Një kthim prapa i lidhur me ilaçet është ndjesia e rikthimit të efekteve të një substance narkotike, pasi efektet e vërteta të ilaçit janë konsumuar). Edhe pse morfina njihet për efektin e saj depresiv, ka eksperimente që tregojnë se morfina në të vërtetë ka një efekt të dyfishtë. Kur merret me masë (doza të vogla), shkakton eufori dhe përgjumje të këndshme, relaksim dhe mungesë shqetësimesh. Personi ndihet i sigurt dhe i mbrojtur, kurse ndjenja e frikës është e panjohur për të.

Përqendrimi i zgjatur zakonisht nuk është i mundur, dëshira për ndonjë aktivitet shuhet, personi bëhet apatik dhe egoist, i orientuar kah vetja, pa vullnet për të marrë pjesë në ndonjë komuni-

kim. Mprehtësia vizuale dobësohet. Shfaqet aktiviteti i ulur motorik dhe inercia mendore, palëvizshmëria, mosveprimi; stabiliteti, pandryshueshmëria, pasiviteti, përtacia, që nxisin një gjumë të thellë pa ëndrra. Frymëmarrja është shumë e ngadaltë, bebëzat ngushtohen dhe temperatura e trupit bie. Kjo mund të çojë në vdekje për shkak të mbidozimit ose në një reagim idiosinkretik në formë të mundimit, paraqiten të vjellat, dridhjet, pagjumësia, ngërçet dhe jermi (somnambulizmi). Morfina është një substancë narkotike që shkakton varësi të madhe. Pas vetëm disa ditësh nga marrja e saj në vazhdimësi, krijohet varësia.

Në botën e varësve nga substancat narkotike, emrat e morfinës gati që janë shndërruar në emra internacionalë. Morfina është e njohur edhe me shprehjet: *maca e vogël, zonja eme, daja, ëndrruesi, emsel* dhe *tab*. Normalisht pos këtyre emrave ekzistojnë edhe shprehje të tjera që varen nga vendi se ku narkomanët jetojnë dhe nga gjuha me të cilën komunikojnë.



KODEINA

Kodeina është një substancë narkotike për qetësimin e dhimbjeve dhe largimin e kollitjes, e ngjashme me morfinën dhe hidrokodonin. Për më tepër, një sasi e vogël e kodeinës shndërrohet në morfinë në trup. Mekanizmi i saktë i veprimit të kodeinës nuk dihet; megjithatë, ngjashëm me morfinën, edhe kodeina lidhet me receptorët në tru (receptorët opioidë) që janë të rëndësishëm për transmetimin e ndjesisë së dhimbjes në të gjithë trupin dhe trurin. Kodeina rrit tolerancën ndaj dhimbjes, duke ulur sikletin (pa rahatinë), por dhimbja përsëri është e dukshme për konsumuesin. Përveç zvogëlimit të dhimbjes, kodeina gjithashtu shkakton sedacion,⁶⁸ përgjumje dhe depresion të frymëmarrjes. Kodeina shpesh kombinohet me acetaminofenin (Tylenol) dhe aspirinën për lehtësim më efektiv të dhimbjes.

Kodeina është drogë më e butë se opiumi dhe morfina, mirëpo assesit nuk guxon të nënçmohet për arsye se shkakton varësi të dyfishtë dhe ndikon fuqishëm në sistemin nervor qendror. Kodeina gjendet në opium në një koncentrim të vogël.



Për treg prodhohet me konversion⁶⁹ prej morfinës. Për prodhimin e saj shpenzohen afro 90% të morfinës të cilën e plasojnë industria farmaceutike. Kodeina është me shije të hidhur. Më së shpe-

⁶⁸ Sedacioni është një gjendje e zvogëluar e vetëdijes që arrihet duke dhënë ilaçe të caktuara që veprojnë në sistemin nervor qendror.

⁶⁹ Konversion vjen nga latinishtja conversio - ndërrim, kthese

shti gjendet në formë të pluhurit të bardhë të kristaleve dhe të tabletave. Është efikase kundër kollës. Doza toksike e saj është 2 miligram (Mg). Përdorimi i kodeinës shkakton dridhjen e trupit, rraskapitje, ndjenjë për grindje me persona të tjerë, pagjumësi, humbje të peshës, si dhe pengesa në të folurit. Duhet të theksohet se nuk çmohet shumë nga narkomanët (të sëmurit nga varësia).

Në opiumin e papërpunuar kodeina është me sasi prej 0,7% deri 2,5%. Reagon në substanca të njëjta sikurse të gjitha derivatet e tjera të opiumit.

Kodeina për herë të parë është izoluar në vitin 1932 në Francë nga Jean-Pierre Robiquet dhe prej të gjithë narkotikëve të cilët janë me prejardhje natyrore, ajo është në masën më të madhe duke u përdorur në mjekësi. Kodeina krijon varësi mendore dhe fizike, por varësia nuk ka gjasa të ndodhë nëse përdoret për një kohë të shkurtër për lehtësimin e dhimbjes.

Nëse kodeina tërhiqet papritmas, pas përdorimit për një kohë të gjatë, mund të zhvillohen simptomat e tërheqjes. Doza e kodeinës duhet të ulet gradualisht për të shmangur simptomat e tërheqjes. Sindroma e abstinencës ose e përmbajtjes nga përdorimi, shkakton një varg simptomash shumë të pakëndshme mendore dhe fizike. Zakonisht simptomat paraqiten në një numër të pacaktuar (tre ose më shumë) të cilat zhvillohen te varësit për shkak të abstinencës (përmbajtjes) nga droga. Pjesë e sindromës mund të jetë deliri i abstinencës.

Duket interesant fakti se ato janë ilaçe, të cilat një kohë të gjatë kanë qenë në shitje të lirë, shumë me vonë janë gjetur në regjistrin e substancave narkotike të kontrolluara.

Rrezikun me të madh për shëndetin e njeriut këto droga e paraqesin kur ato përdoren të kombinuara me alkool.



TEBAINA

Bima e lulëkuqes së opiumit (*Papaver somniferum*) përmban gjashtë alkaloidë që zakonisht përdoren për prodhimin e ilaçeve dhe produkteve komerciale. Tre analgjetikë të përdorur më së shpeshti janë:

opiumi, morfina, kodeina dhe, në një masë më të vogël për shkak të toksicitetit të saj më të madh, tebaina.



Tebaina është pararendëse e njërit prej analgjetikëve më të vjetër të historisë, morfinës. Tebaina është e njohur edhe si paramorfinë për shkak të efekteve të saj stimuluese - në krahasim me efektet depresive të morfinës dhe kodeinës. Është alkaloid helmues i opiumit, i pangjyrë dhe pa erë, tretet në alkool dhe eter; ndërsa në sasi të vogla shkakton ngërçe. Emri i tebainës (paramorfinës) vjen nga - *Teba*, një qytet antik në Egjiptin e Epërm. Tebaina është një përbërës pakicë i opiumit, e cila në pikëpamje kimike është e ngjashme me morfinën dhe kodeinën, por ka efekte stimuluese dhe jo depresive. Tebaina shkakton konvulsione në doza më të larta; nuk ka përdorim terapeutik, por si alkaloidi kryesor i nxjerrë nga lulëkuqja e opiumit, shndërrohet në një numër komponimesh (përbërësish) si: *oksikodoni*, *oxymorfon*, *nalbupina*, *naloksoni*, *naltreksoni*, *buprenorfin* dhe *etorfin*.

Opiumi përmban midis 0.3% deri 1.5% të tebainës (por është raportuar edhe deri në 6% në disa specie). Klasifikohet si narkotik konvulsiv dhe si i tillë, është një produkt legal dhe i njohur ndërkombëtarisht. Derivatet natyrale dhe sintetike të tebainës përdoren si “material fillestar” për disa ilaçe, për të ndihmuar në absorbim (përthithje). Mund të gjendet në mesin e një liste të gjatë të përbërësve, në një sërë opioidesh me recetë nga mjeku (në mënyrë legale) përfshirë *Buprenorphine*, *Oxycodone*, *Oxymorphone* dhe *Naloxone*.

Efektet e tebainës janë të ngjashme me ato të opioidëve të tjerë, por dallon në mënyra të ndryshme për shkak të tendencës së saj për të shkaktuar konvulsione⁷⁰ të pavullnetshme. Mund të bllokojë sinjalet e dhimbjes, por, si një agonist i pjesshëm, nuk është i lidhur fort me euforitë e shkaktuara nga substancat narkotike si vikodini⁷¹ dhe heroina. Për më tepër, substanca konsiderohet toksike. Abuzimi shkakton spazma të muskujve të ngjashme me efektet e strikininit (që gjendet në helmin e miut) dhe është veçanërisht i ndryshëm nga bllokimet e shkaktuara potencialisht nga morfina. Në fakt, në studimet mbi tebainën, në aspektin e keqpërdorimit, nuk mund të arrihej asnjë tolerancë ndaj efekteve konvulsive të tij.

70 *Konvulsioni* përkufizohet si çrregullim i pavullnetshëm i funksionit të trurit, që manifestohet me humbje ose pa humbje të vetëdijes. P. sh. *Epilepsia* përkufizohet si konvulsion periodik (që përsëritet herë pas here).

71 *Vikodina* (*hidrokodon / acetaminofen*) është një kombinim i hidrokodonit narkotik dhe acetaminofenit qetësues të dhimbjes, jo-narkotikë të përdorur për lehtësimin e dhimbjes mesatare deri mesatarisht të rëndë.

HEROINA

Opiatetet gjysmë sintetike

(Heroina, Oksikodoni, Bubrenorfina, Hidromorfina dhe Oksimorfona)

Heroina (Diacetilmorfina) është një opiat gjysmë-sintetik i përpunuar nga morfina, e cila është derivat i opiumit (lulëkuqes) dhe është shumë më vështirë të prodhohet në krahasim me kokainën. Për prodhimin e saj nevojitet dituri profesionale, laboratorë me pajisje të mira, fusha pjellore të mbjella me lulëkuqe të opiumit (të njohura me emrin latin *Paper somniferum*) dhe me shumë diell. Duhet të përmendet se lulëkuqja e opiumit, me kualitet jashtëzakonisht të lartë, kultivohet edhe në luginën e Vardarit, duke përfshirë edhe qytetin e Kumanovës me rrethinë.



Heroina përbëhet prej kristaleve të imta, të cilat janë të ngjashme me sheqerin pluhur, miellin e klasës së parë apo detergjentin. Ngjyra e heroinës ndryshon prej të bardhës deri të ngjyra e ashtit të fildit (ngjyrë fildishi), pastaj mund të jetë ngjyrë gështenje, e verdhë, apo në mes të së verdhës dhe gështenjës, me shije e cila i përngjan shijes së uthullës. Ngjyra dhe kualiteti i heroinës varet nga vendi ku prodhohet dhe prej substancave me të cilat përzihet. Heroina më e pastër është me ngjyrë të bardhë dhe ka shije të hidhët. Nëse heroina është për një kohë të gjatë e ekspozuar në ajër atëherë dalëngadalë do ta ndërrojë ngjyrën në të errtë.

Heroina evropiane dhe ajo nga Orienti është me nuanca më të shkëlqyeshme, që do të thotë se është fjala për një shkallë të lartë kualitetit dhe pastërtie. Heroina meksikane zakonisht është me ngjyrë më të errët dhe më tepër në formë të kokrrizave çka e bën më pak të pastër.

Heroina, e cila shitet në rrugë përzihet me substanca të tjera, siç janë: sheqeri, nishesteja, qumështi në formë të pluhurit, apo kinina (mjet kundër rritjes së temperaturës). Heroina, e cila shitet në rrugë mundet, gjithashtu, të jetë e përzier me strikninin⁷² apo me helme të tjera. Ata të cilët e keqpërdorin heroinën nuk e njohin fuqinë e as që dinë se çka krejt përmban ajo në vete, kështu që janë të ekspozuar ndaj rrezikut të madh nga mbidozimi dhe vdekja. Stërs-hitësit të cilët e shesin heroinën e përziejnë me substanca të tjera në raport 9 me 1 deri në 99 me 1. Kjo do të thotë se heroina e cila shitet në rrugë nuk ka më shumë se 3% deri 8% heroinë të pastër, pjesa tjetër, 92% deri 97% janë substanca krejtësisht të tjera, të cilat u përmendën më parë.



Në fjalorin e rrugës, heroina më së shpeshti quhet *H, miell, kali, bërlllok* etj. Heroina është substanca narkotike më e abuzuar e cila e ka veprimin më të shpejtë nga të gjitha substancat e tjera narkotike. Konsumohet në mënyrë intravenoze, përmes pirjes dhe përmes nuhatjes.

Në treg paraqitet zakonisht si gjysmë prodhim në procesin e përpunimit ose si prodhim final. Në bazë të kësaj edhe janë standardet e llojet e heroinës:

Heroina 1 - më së shpeshti prodhohet në Azi, në Trekëndëshin e artë, për shkak të transportit më të lehtë në laboratorët e Tajlandës dhe Miamës (ish Birmania). Në territorin e Lindjes së Mesme dhe Meksikës, është e rrallë, sepse heroina prodhohet drejtpërdrejt nga opiumi i papërpunuar. Është me ngjyrë të përhimë (të murrme) në të gështenjtë apo me ngjyrë të zezë.

Heroina 2 – është e papërpunuar, gjysmë prodhim i njohur me emrin Tsao Ta. Ajo është substancë e ngurtë, e cila mund të grimcohet (imtësohet) në thërmija të vogla pluhuri, me ngjyrë të murrme të çeltë kah ngjyra gështenjë e mbyllur. Prodhohet në Azi si lëndë e parë (e papërpunuar) për dy lloje finale të heroinës – për pirje si cigare dhe për injektim.

Heroina 3 – është e përgatitur për pirje si cigare. Mund të tretet me aceton apo me thartinë të limonit dhe të injektohet. Është me strukturë të kokrrave me ngjyrë të murrme kah e verdha dhe e murrme në të verdhë, shpesh është e përzier me kafeinë. Është e njohur me emrin *White Dragon Pearl* dhe *Brown Sugar Heroin*.

Heroina 4 – prodhohet për injektim. Prodhohet shumë e pastër, por për shkak të rritjes së volumit në rrugë shitet e përzier me shumë substanca shtesë. Ky është pluhur i bardhë në të verdhë.

Heroina e zezë (apo ngjyrë gështenjë) - fitohet me procesin e drejtpërdrejtë, pa pastrim paraprak.

⁷² Striknini është një helm shumë i fortë. Merret nga bimët të llojit *Strychnos*. Është një alkaloid shumë i qëndrueshëm, i ruajtur mirë dhe lehtë mund të zbulohet në kufoma pas helmimit. Zakonisht përdoret për të vrarë gjitarët e vegjël (kryesisht minjtë) dhe shpendët. Vdekja mund të ndodhë brenda gjysmë ore.

Është e murrme, por edhe e zezë. Është me copa të forta.

Vështirësitë shëndetësore

Keqpërdorimi i heroinës është i lidhur me probleme serioze shëndetësore, duke llogaritur dozën e tejkaluar, abortin spontan shkatërrimin apo dëmtimin e venave si dhe sëmundjet infektive HIV/ SIDA⁷³ dhe Hepatitin C.⁷⁴

Efektet afatshkurta paraqiten menjëherë pas përdorimit të heroinës dhe zhduken pas disa orëve. Pasi që të injektohet me shiringë shfrytëzuesin e kaplon vala e euforisë,⁷⁵ së bashku me ndjenjën e nxehtësisë, me ekstremitetet e rënduara dhe me tharjen e buzëve. Pas euforisë fillestare shfrytëzuesi bie herë në gjendje gjumi dhe herë në gjendje pagjumësie. Funksionet mentale bëhen të megjulluara dhe shkaktohet depresioni i sistemit nervor qendror. Opiatet e forta indukojnë një ndjenjë vetëkënaqësie e lumturie. Dhimbja sikur largohet dhe aktiviteti i sistemit nervor qendror zvogëlohet, frymëmarrja dhe ritmi i zemrës ulen, kurse refleksi i kollës inhibohet⁷⁶(ndalet). Me doza më të larta rriten shanset për humbjen e vetëdijes, nganjëherë kjo sjell deri te koma, e në raste të rralla shkakton vdekjen nga bllokimi i organeve të frymëmarrjes.

Efektet afatgjata të heroinës lajmërohen pas përsëritjes së konsumimit të saj gjatë një periudhe të caktuar kohore. Te shfrytëzuesit kronikë mund të ndodh dëmtimi dhe shkatërrimi i venave, infektimi i muskujve të zemrës, të thatit dhe sëmundjet e mëlçisë. Mund të paraqiten kompliki-

73 AIDS – Acquired Immune Deficiency Sindrom (Angl.).

SIDA – Syndrome d'Immuno Deficience Acquis (Frëngjisht). Sindromi i humbjes së aftësisë së mbrojtjes imunologjike. Shprehjet për fazën më të rëndë dhe të fundit të sëmundjes së shkaktoar nga virusi i HIV-it. HIV – Human Immunodeficiency Virus (Virusi i pamjaftueshmërisë imunologjike njerëzore). Është virus njëzinxhiror nga familja e retrovirusëve. Ekzistojnë dy tipa kryesorë: HIV-1 i përhapur në tërë botën dhe HIV-2 i ashtuquajtur tip i afrikan. Që të dy tipat i takojnë nënfamiljes së LENTIVIRUSËVE (Latinisht LENTË – virus me veprim të ngadalshëm).

74 **HEPATITI** – është shprehje e përgjithshme për inflamacionin (ndezen) e mëlçisë, i shkaktoar nga virusi me të njëjtin emër, i cili i takon grupit RNA (Ribonucleic acid) të viruseve. Alkooli, kemikalet dhe narkotikët mund të jenë gjithashtu shkaktarë të Hepatitit. Ekzistojnë disa lloje të Hepatitit si: A,B,C,D,E,F dhe G. Por më të njohur janë: Hepatiti A, B dhe C.

HEPATITI C – është shumë i shpeshtë te varësit të cilët drogën e marrin në mënyrë intravenoze. Gati 60% e konsumuesve intravenozë janë të infektuar me Hepatitin C, i cili shkakton sëmundjen e mëlçisë me një rrjedhje të ngadalshme dhe me një kohëzgjatje më të madhe. Simptomat e infektimit mund të ndjehen me vite të tëra, kurse personi i infektuar për shkak të pamundësisë të mjekimit është bartës i përhershëm i infektimit. Bartet me anë të gjakut për shkak të përdorimit të përbashkët të mjeteve intravenoze (gjilpëra, shiringa, etj.) Vlen të theksohet se është shumë vështirë të shkatërrohet virusi për shkak të rezistueshmërisë ndaj nxehtësisë. Për këtë arsye, në pengimin e zgjerimit të infektimit me virusin e Hepatitit C edhe sterilizimi në temperatura shumë të larta nuk ka kurrfarë efekti te gjilpërat të cilat janë përdorur më parë. Deri më tani nuk është zbuluar vaksina efikase për shkatërrimin e virusit të Hepatitit C.


HEPATITI B – është sëmundje e rëndë e mëlçisë e shkaktoar nga virusi, i cili gjendet në gjak, sekretin e hundës, ejakulatin, sekretin vagjinal etj. Bartet me anë të kontakteve seksuale, me anë të gjakut dhe me anë të përdorimit të mjeteve intravenoze te konsumuesit e drogës. Nuk ekziston ilaç për shërim pos vaksinë për mbrojtje nga infektimi.

HEPATITI A – është sëmundje inflamatore e shkaktoar nga virusi i cili gjendet në nevojën e madhe (fekale) të personave të infektuar. Virusit bartet nëpërmjet duarve të ndyta, me anë të ujit, ushqimit dhe kushteve të tjera jo higjienike.

75 Gjendje shpirtërore e sëmurë, kur njeriu pushtohet nga ndjenja të forta gëzimi, kënaqësie apo lumturie, e cila shkaktohet nga ndonjë sëmundje nervore, nga veprimi i substancave narkotike, pijeve alkoolike, etj. Në psikologji: një ndjenjë patologjike, e paarsyeshme ose paradoksale e lumturisë në sëmundjet shpirtërore afektive.

76 Inhibicioni është një term shumë kompleks që ka shumë domethënie. Sipas përkufizimit inhibicion do të thotë: frenimi, ngadalësimi ose paafëtesia e një procesi të veçantë mendor ose fiziologjik.

me të rënda të mushkërive, duke përfshirë dëmtimin e mushkërive si pasojë e gjendjes së ligë shëndetësore, për shkak të mosushqimit të rregullt dhe cilësisë së dobët të ushqimit e shoqëruar me neglizhencë personale, por edhe për shkak të efekteve negative, depresive të heroinës në frymëmarrje.



Pos efekteve negative që i shkakton vetë substanca narkotike, heroina e rrugës, siç përmendëm, përmban edhe shtojca, të cilat nuk treten lehtë (zakonisht përziehet me substanca të tjera si kafeina, kinina, pudra, mielli etj. që shkaktojnë zënien (mbylljen) e enëve të gjakut, të cilat shkojnë në mushkëri, mëlçi, veshkë apo në tru. Natyrisht, përdorimi i përbashkët i mjeteve për injektim mund të shkaktojë infektme siç janë Hepatiti B dhe C, SIDA/HIV si dhe viruse të tjerë të shumtë, të cilët gjenden në gjak dhe narkomanët mund t'i bartin te partnerët e tyre seksualë dhe te fëmijët. Përdorimi për një kohë të gjatë i heroinës shkakton ulje të dëshirës seksuale, çrregullim të ciklit menstrual dhe mungesë oreksi.

Toleranca dhe abstenimi

Te përdorimi i rregullt i heroinës zhvillohet toleranca. Kjo do të thotë se shfrytëzuesi duhet të marrë gjithnjë e më shumë heroinë për të arritur intensitetin e efektit të njëjtë, të cilin e prodhon droga. Gjatë rritjes së dozës, me kohë, zhvillohet edhe varësia psikike dhe fizike. Me varësinë fizike, trupi adaptohet me prezencën e drogës dhe nëse përdorimi i saj zvogëlohet, apo në tërësi ndërpritet, atëherë shkaktohen kriza të abstenimit.

Abstenimi, i cili te shfrytëzuesit e rregullt mund të lajmërohet edhe disa orë pas përdorimit të fundit të drogës, krijon përmallim, shqetësim, dhimbje në eshtra dhe në muskuj, pagjumësi, diarre dhe të vjella, ndjenjë të të ftohtit, rrëqethje të lëkurës, shtangie dhe simptoma të tjera. Intensiteti më i fortë i krizës abstinenciale lajmërohet 48-72 orë pas përdorimit të fundit të drogës dhe gradualisht zhduket pas 7 deri 10 ditësh. Kriza abstinenciale e papritur te varësit e rëndë, të cilët kanë shëndet të dobët, mund të jetë fatale, edhe pse mendohet se abstenimi prej heroinës është shumë më pak i rrezikshëm se sa abstenimi nga alkooli apo drogat e tjera.

Shenjat e abuzimit

Një përdorues i heroinës mund të tregojë shenja të tilla si apati, lënie pas dore të higjienës personale, humbje oreksi dhe rënie të peshës trupore, humbje të interesit për argëtimet dhe aktivitetet e mëparshëm, mospërfillje ndaj aktiviteteve sociale, ndaj personave që e rrethojnë dhe ndaj detyrimeve individuale. Përdoruesi i drogës shpesh orientohet ndaj krimit për të vazhduar financimin dhe blerjen e drogës.

Përdorimet e ligjshme

Heroina përdoret gjerësisht në sistemin mjekësor në Britani dhe në Belgjikë, për trajtimin e dhimbjeve tepër të forta, si p. sh. ato që vijnë pas goditjes në zemër, dhimbjeve të veshkës, si dhe trajtimin e kollës. Nuk përdoret nga mjekësia e vendeve të tjera. Opiatet e tjera si morfina dhe metadoni përdoren si anestetikë. Shumica e opiateve janë të klasifikuara si droga të klasës A. Opiatët e "buta" si kodeina (Codeine) përfshihen nganjëherë në ilaçet kundër kollës dhe në preparatet kundër diarresë.

Mënyrat e keqpërdorimit të heroinës

Heroina pihet si duhan, thithet me hundë, apo injektohet me shiringa (intravenoze apo nën lëkurë). Thithja me hundë është mënyra më e shpeshtë e përdorimit të heroinës, pasi shumë shpejt, nëpërmjet të mukozës së hundës, depërton në gjak.

Pirja e heroinës si duhan është një nga format e zakonshme të përdorimit në Evropë, por kjo formë e konsumimit ekziston edhe në viset e tjera duke llogaritur edhe viset tona. Kur heroina thithet me anë të hundës, apo pihet si duhan, efektet maksimale hetohen në afat prej 10 deri 20 minutash. Edhe pse pirja e heroinës si duhan dhe me anë të thithjes nëpërmjet hundës, nuk krijojnë shqetësime me shpejtësi të njëjtë si injektimi intravenoz, hulumtimet kanë vërtetuar se të tri format e marrjes së heroinës krijojnë varësi të intensitetit të lartë. Marrja e heroinës në mënyrë intravenoze shkakton efektet më të forta dhe më të shpejta. Reaksioni i parë pas injektimit është shtangimi i plotë i organizmit në përgjithësi, pastaj lajmërohet ndjenja e gëzimit apo e lumturisë dhe e lirit nga

frika e brengat. Zakonisht, konsumuesi i heroinës injekton drogën deri katër herë në ditë. Injektimi intravenoz shkakton fillim shumë të shpejtë dhe intensiv të euforisë, derisa injektimi intramuskulor shkakton fillim relativisht të ngadalshëm të euforisë. Injektimi edhe më tutje është forma më dominuese e marrjes së heroinës në mesin e varësve të cilët kërkojnë ndihmë profesionale. Megjithatë, hulumtuesit kanë dalluar (vërejtur) ndryshimin në marrjen e heroinës, sepse prej injektimit është duke u kaluar gjithnjë e më tepër në pirje si duhan dhe thithje me hundë.



Varësia nga Heroina

Heroina shkakton varësi të madhe. Është një opiat i cili lidhet me receptorët në tru për të liruar dopaminën kimike. Nëse personi merr opiate për një kohë të gjatë, natyrisht truri nuk prodhon dopaminë si dikur. Kjo bën që personi të marrë doza më të larta ose më të shpeshta të opiateve për të arritur të njëjtin nivel të ndjenjës.

Ndonjëherë, çrregullimi i përdorimit të opiateve fillon me ilaçe legale, si ilaçet kundër dhimbjeve të përshkruara nga mjeku pas operacionit ose pas ndonjë lëndim. Këto ilaçe kundër dhimbjeve veprojnë në të njëjtën mënyrë si heroina.

Nëse personi bëhet i varur nga këto ilaçe të përshkruara dhe pastaj nuk mund t'i marrë më ato në mënyrë legale, ai mund të kalojë në substanca ilegale, si heroinë, për të arritur të njëjtën ndjenjë të kënaqësisë. Edhe pse jo të gjithë ata që marrin qetësues (ilaxe) ligjorë janë bërë të varur, por disa njerëz nuk do të jenë në gjendje të ndalojnë marrjen e tyre. Vartësia ndaj heroinës fillon me një vartësi molisjeje, shkatërruese pas përdorimit të drogës çlodhëse. Pavarësisht të gjitha pasojave negative, përdoruesit e heroinës ndihen të paaftë për t'u larguar nga kthetrat e varësisë. Heroina shkakton vartësi të fortë fizike dhe mendore, merr kontrollin e mendjes dhe të trupit. Substanca narkotike merret për të krijuar eufori në një mënyrë për të përjetuar diçka pozitive në jetët e tyre.

Ndikimi i heroinës te shtatzënat

Keqpërdorimi i heroinës mund të jetë shkaktar i komplikimeve serioze te nënat shtatzëna, siç janë abortet spontane dhe lindjet e parakohshme. Fëmijët e lindur nga nënat që janë të sëmura nga varësia e substancave narkotike janë të ekspozuar ndaj rrezikut më të madh për të marrë sindromën e vdekjes së papritur të të porsalindurve⁷⁷. Shtatzënat nuk mund t'i ekspozohen detoksimit për shkak të rrezikut të rritur nga aborti spontan dhe lindjes së parakohshme. Preferohet mjekimi me metadon, edhe pse fëmijët të cilët i kanë lindur nënat që kanë marrë metadon mund të tregojnë shenja të varësisë fizike, prandaj ndaj tyre duhet pasur kujdes të veçantë.

⁷⁷ Sudden Infant Death Syndrome – SIDS

Pse konsumuesit e heroinës i janë të ekspozuar rrezikut më të madh për t'u infektuar me virusin e AIDS/HIV, si dhe Hepatitit B dhe C?

Shumica e varësve nga heroina e përdorin të njëjtën shiringë dhe mjetet e tjera të injektimit, prandaj ata janë të ekspozuar ndaj rrezikut më të madh për t'u infektuar me virusin HIV dhe të sëmundjeve të tjera infektive. SIDA është sëmundja më e përhapur në mesin e narkomanëve, të cilët injektojnë drogën duke përdorur gjilpëra dhe shiringa, që përdorin mjete të tjera të kontaminuara (të infektuara) nga ana e disa personave, si dhe me anë të marrëdhënieve seksuale pa mbrojtje me personat të cilët janë HIV pozitivë. Është fakt se HIV - i më së shpejti (dhe më së shpeshti) bartet në mesin e grupimit i cili keqpërdor drogën. Hulumtimet, të cilat i ka bërë Instituti amerikan nacional i keqpërdorimit të drogave (NIDA – National Institute on Drug Abuse)⁷⁸ kanë treguar se narkomanët mund t'i ndërrojnë sjelljet të cilat i shpiten në rrezik të infektimit me virusin e HIV/SIDA, me anë të mjekimit, preventivës dhe programit, i cili aplikohet në bashkësi. Me ndërprerjen e marrjes së drogës evitohet edhe rreziku, siç është ai i përdorimit të përbashkët të gjilpërës dhe shiringës, seksit pa mbrojtje, si dhe rreziku nga ekspozimi ndaj virusit HIV/SIDA apo sëmundjeve të tjera infektive. Preventiva dhe mjekimi i keqpërdorimit të drogës janë faktorë shumë me rëndësi në parandalimin e bartjes së virusit të HIV-it dhe SIDA-s.

Shenjat apo simptomat, të cilat na japin të kuptojmë konsumimin e heroinës

Duke i studiuar dukuritë të cilat tregojnë se ndonjë person është nën ndikim të narkotikëve, mund të përcaktohen këto manifestimet vijuese:

- Shenjat e lëndimeve të vogla në duar të shkaktuara nga injektimi në vena.
- Ngushtimi dhe fiksimi i bebëzave të syve menjëherë pas përdorimit të drogës Nëse substanca narkotike përdoret për një kohë të gjatë, bebëzat zgjerohen në mënyrë të qartë, sidomos para fillimit dhe në fillim të krizës së abstinencës;
- Humbja e oreksit dhe përdorimi i shpeshtë i "bonboneve", ëmbëlsirave dhe pijeve të ëmbla;
- Sytë mund të jenë të skuqur dhe me lot. Lajmërohet kolla, e cila menjëherë pasi që të merret doza e re e drogës ndalet. Në kohën e abstenimit mund të lajmërohet mundimi dhe të vjellat, lëkura e të droguarit është nganjëherë e rrëqethur, konsumuesi shpesh është i përgjumur dhe ka dridhje të lehta. Këto simptoma zhduken kur të merret droga;
- Varësi çdo 4-6 orë largohet nga shoqëria për t'i dhënë vetes injeksion të ri droge;
- Zakonisht në çantën e varësit gjenden shiringa, injeksione, lugë, apo kapakët metalikë të shisheve, të cilët nevojiten për tretjen e drogës (zakonisht janë me blozë për shkak të nxehjes), vatë, shishe të vogla të ilaçeve etj.
- Varësi shpesh është me pamje të rraskapitur, në një gjendje letargjike (gjysmë gjumi). Ndodh që edhe në shoqëri ta zë gjumi, përnjëherë zgjohet dhe prapë bie në gjumë.

⁷⁸ NIDA – National Institute on Drug Abuse NIH Publication Number 02-4210. Prindet April 1998, Reprndet January 2002

OKSIKODONI

Oksikodoni, (*oxycodone hydrochloride*) është një produkt i modifikuar që zakonisht në treg shitet me emrin OxyContin. Oksikodoni është një analgjetik opioid që është sintetizuar nga derivati i opiumit *tebainë*. Është sintetizuar në Gjermani në vitin 1916, si një nga disa opioidet gjysmë sintetike në përpjekje për të përmirësuar opiatet ekzistuese: morfinën, diacetilmorfinën dhe kodeinën.



Oksikodoni është një ilaç që merret me rrugë orale dhe zakonisht përshkruhet për të lehtësuar dhimbjet mesatare më të forta. Ky është një opioid analgjetik që u përshkruhet pacientëve dhe personave me dhimbje kronike, pas operacioneve të vështira kirurgjike dhe kundër dhimbjeve të shpinës dhe qafës. Mund të përshkruhet gjithashtu tek pacientët me kancer, për të zvogëluar dhimbjen dhe për

të përmirësuar funksionimin e organeve. Në doza të ulëta gjithashtu përshkruhet për të lehtësuar përkohësisht diarrenë. Në përgjithësi, për shkak të efektit të tij të fortë oksikodoni përdoret kundër lehtësuesve të tjerë të dhimbjeve që merren disa herë në ditë. Por përpos mjekimit të dhimbjeve fizike, filloi të keqpërdoret për të ashtuquajturën dhimbje mendore apo shpirtërore. Këto ilaçe janë më të lira, legale dhe më të lehta për t'u marrë sesa substancat e tjera narkotike, për shkak të faktit se mund të përmbajë një sasi të madhe të analgjetikëve.

Oksikodoni, është bërë një nga substancat më të keqpërdorura në Amerikën Veriore (SHBA dhe Kanadë) dhe në tërë botën. Shumë njerëz që abuzojnë me oksikodonin në fillim e marrin rregullisht sasinë e caktuar të përshkruar nga mjeku - por pasi organizmi i tyre zhvillon tolerancë ndaj ilaçit, atyre u duhet një dozë gjithnjë e më e lartë për të ruajtur të njëjtin lehtësim dhe zbutje të dhimbjeve. Kalimi nga përdorimi i caktuar në keqpërdorim, e deri te varësia, mund të jetë një rrugë e shpejtë dhe e rrezikshme. Oksikodoni është një ilaç i fuqishëm dhe ofron lehtësim të nevojshëm për shumë njerëz që luftojnë gjendjet me dhimbje të mëdha ose sëmundje terminale, prandaj si i tillë, është shumë vështirë të mbahet nën kontroll. Varësia nga oksikodoni është një gjendje shumë e rëndë - jo vetëm që është një varësi e shtrenjtë dhe rraskapitëse, por mbidoza me oksikodon realisht shkakton vdekjen. Edhe përkundër masave të marra për të ndaluar abuzimin me këtë ilaç, oksikodoni vazhdon të abuzohet dhe të keqpërdoret. Për më tepër, ka një rritje të abuzuesve të oksikodonit.

Në treg gjendet në formë të prodhimit me një apo më shumë përbërës. Shembull i zakonshëm me disa përbërës është oksikodoni me acetaminofenin/paracetamolin ose ibuprofenin. Formulimet janë në dispozicion si gjenerikë dhe nën emra të ndryshëm komercial.

BUPRENORFINA

Buprenorfina është një ilaç që përdoret për mjekimin e varësisë nga opiumi. Ilaçi funksionon dhe vepron duke u lidhur me receptorët e opiumit, me ç'rast lirohet dopamina. Buprenorfina përdoret më shpesh gjatë detoksikimit të varësisë nga heroina (metadoni) në mënyrë që të parandalohet zhvillimi i simptomave të krizës sa më shumë që të jetë e mundur, ose nëse simptomat kanë ndodhur, që të zvogëlohen ndjeshëm vuajtjet. Përveç detoksikimit, buprenorfina është treguar gjithashtu se është një ilaç shumë efektiv në trajtimin e abstinencës (të ashtuquajturat terapi zëvendësuese) për një periudhë më të shkurtër ose më të gjatë.



Vetëm prania e buprenorfinës në trup bllokoi veprimin e heroinës dhe çon në eliminimin e problemeve të abstinencës; ka një veprim antidepressiv dhe me kalimin e kohës, dëshira e pacientit për substancën (heroinë, metadon) zvogëlohet ndjeshëm. Pacienti ka mendime më të qarta dhe kontroll më të mirë mbi veten. Me përdorimin e duhur (të caktuar, të rregullt) të buprenorfinës, pa-

cienti nuk mund të mbidozohet. Me rëndësi është të dihet se buprenorfina nuk duhet të merret në kombinim me bllokues si p.sh. Nalorex, sepse nxitë simptoma të krizës së abstinencës. Gjithashtu, buprenorfina nuk duhet të kombinohet me alkoolin, qetësuesit dhe disa antidepressantë, sepse kombinimi i tyre mund të jetë fatal. Duhet gjithashtu të theksohet se buprenorfina ka potencial për krijimin e varësisë (e cila është më e ulët në krahasim me metadonin) dhe nëse papritmas ndërpritet marrja e buprenorfinës, do të lajmërohen simptoma të një krize të abstinencës. Kriza ndodh gradualisht, simptomat janë me intensitet më të butë në lidhje me krizën e heroinës dhe kohëzgjatja e saj është rreth 7 ditë.

Ilaçi mund të përdoret në mënyrë të sigurt vetëm në dozat dhe në mënyrën e përshkruar nga mjeku!

Në opioide gjysmë sintetike bëjnë pjesë edhe dy substanca narkotike, **Hydromorfina** dhe **Oksimorfoni** të cilët përdoren kryesisht në mjekësi për lehtësimin e dhimbjeve kronike.

HIDROMORFINA

Hidromorfina (Hydromorphone, emrat komercial: Palladone IR, Dilaudid, Jurnista) është një analgjetik i fuqishëm qendror i klasës së opioidëve; është një derivat i Morfinës, është një ilaç gjysmë sintetik, një opioid dhe një lëndë narkotike e vërtetë. Përdoret në mjekësi si një alternativë e morfinës. Hydromorfini vepron më shpejt dhe është rreth tetë herë më i fortë se morfina dhe tri herë më i fortë se heroina mbi një bazë miligrami. Kalimi efektiv nga morfina në hydromorphone mund të ndryshojë nga pacienti në pacient.



Hydromorphone po bëhet gjithnjë e më i kërkuar në trajtimin e dhimbjeve kronike në shumë vende dhe përdoret gjithashtu si një terapi zëvendësuese e heroinës. Toleranca zhvillohet shumë ngadalë me hidromorfina, në krahasim me metadonin. Ndonjëherë është e nevojshme të ulet doza pas një kohe të caktuar për shkak të veprimit specifik të hydromorfinës. Hydromorfina u sintetizua (nga morfina) për herë të parë në Gjermani në vitin 1921 dhe u fut në praktikën klinike po atë vit. Hidromorfina zakonisht është parë si një ilaç i linjës së dytë të morfinës në trajtimin e dhimbjeve akute dhe kronike (kancerit dhe në një masë më të vogël në dhimbje kronike jo-malinje etj.).

Morfina orale është ilaçi i zgjedhjes së parë për dhimbje kronike nga kanceri, rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetit. Pavarësisht nga ky rekomandim, një pjesë e konsiderueshme e

pacientëve nuk arrijnë lehtësim adekuat të dhimbjes me morfinë, zakonisht për shkak të efekteve të padëshirueshme si nausea⁷⁹, deliriumi ose mioklonus⁸⁰. Është treguar se kalimi nga një opioid në tjetrin mund të përmirësojë kontrollin e dhimbjes, si dhe të zvogëlojë toksicitetin e lidhur me opioidin, megjithëse mekanizmat janë të paqartë.

Personat që abuzojnë me hidromorfonin e bëjnë këtë zakonisht për të krijuar një gjendje të euforisë, relaksimit ose qetësimi. Disa individë gjithashtu mund ta marrin ilaçin për të vetëmjekuar ankthin ose dhimbjen fizike. Këto janë disa nga arsyet pse hidromorfini abuzohet.

Hidromorfini gjendet në disa forma dhe të gjitha nga to mund të keqpërdoren. Ky ilaç mund të përshkruhet si injeksion, tableta dhe tretës në formë të lëngut. Përveç formave gjenetike të ilaçit, hidromorfini me recetë shitet në treg me emra komerciale si: Dilaudid, Dilaudid-HP dhe Exalgo.

Hidromorfina zakonisht abuzohet në mënyrë orale ose me injeksion, megjithatë, disa individë mund ta marrin substancën narkotike përmes nuhatjes ose ta shtypin dhe të përpiqen ta nuhasin apo ta tymosin. Pavarësisht nga mënyra e abuzimit të ilaçit, mund të ekzistojë rreziku i varësisë dhe mbidozimit.

⁷⁹ Ndjesia e të përzierave apo edhe të vjellat për arsye të ndryshme shëndetësore.

⁸⁰ Myoclonus i referohet kërcitjeve të papritura, të shkurtra të pavullnetshme ose kërcitjes së një muskuli ose grupi të muskujve. Ajo përshkruan një shenjë klinike dhe nuk është në vetvete një sëmundje. Shtrembërimi nuk mund të ndalet ose kontrollohet nga personi që e përjeton atë.

Kur abuzimi me hidromorfinë merr modele të detyrueshme të varësisë, shprehitë e përditshme të një personi zakonisht ndryshojnë për të krijuar hapësirë për kërkime dhe përdorime të shpeshta të drogës. Marrja e hidromorfinës gjithashtu mund të ndikojë në sistemin nervor qendror dhe sistemin e qarkullimit të gjakut. Kjo mund të shkaktojë rrahje të ngadaltë ose të shpejtë të zemrës ose ndryshime në presionin e gjakut. Injektimi i hidromorfinë në vena është një mënyrë shumë invazive⁸¹ për të marrë një ilaç që mbart rreziqe të mëdha, përfshirë një infeksion serioz të lëkurës dhe indeve përreth. Njerëzit që ndajnë gjilpëra gjithashtu kanë një rrezik më të lartë të infektimit me HIV / AIDS, hepatit ose sëmundje të tjera infektive.



Individët që abuzojnë me hidromorfinën, në çfarëdo mënyre qoftë, mund të shkaktojnë probleme serioze të zemrës ose të frymëmarrjes, si një efekt anësor afatgjatë i abuzimit. Gratë shtatzëna që abuzojnë me këtë ilaç, gjithashtu, mund t'i ekspozojnë foshnjat e tyre ndaj rreziqeve të mëdha, duke përfshirë peshën e ulët të lindjes, sindromën e abstinencës së lindjes ose abortin.

Hidromorfina abuzohet shpesh me ilaçet e tjera. Kjo mund të rrisë rrezikun e varësisë. Bashkëprimet e ilaçeve, shkaktojnë mbidozë e me këtë edhe probleme serioze shëndetësore.

Abuzimi i hidromorfinës mund të shkaktojë depresion të sistemit nervor qendror. Kur ky ilaç merret me depresorë të sistemit nervor qendror, siç janë alkooli ose ilaçet benzodiazepine, ky efekt mund të jetë shumë më intensiv. Prandaj, përzierja e hidromorfinës (si edhe e të gjithë opioideve) me alkoolin ose benzodiazepinet mund të shkaktojë ritme të ngadalta të rrezikshme të zemrës, probleme të rrezikshme të frymëmarrjes, gjendje kome dhe mbidozime.

Si një narkotik i fuqishëm abuzimi, hidromorfina mund të shkaktojë gjumë shumë të thellë që mund të rezultojë me gjendje kome dhe depresion të frymëmarrjes që kërcënon jetën. Mbidozimi me hidromorfinë shkakton vdekjen.

81 Invaziv ("Pushtues"), i referohet një tumori ose infeksioni që zhvillohet dhe i sulmon pjesët e tjera të trupit.

OKSIMORFINA

Oksimorfina, emri komercial Opana, është një ilaç i cili përshkruhet nga mjeku si një analgjetik narkotik i njohur edhe si qetësues. Ilaçet opioide përdoren për të trajtuar dhimbjet nga mesatare deri te ato të forta, veçanërisht te pacientët me dhimbje kronike ose sëmundje që shkaktojnë dhimbje kronike, siç është kanceri. Ilaçet nuk janë të destinuara për përdorim afatgjatë për shkak të vetive të tyre të varësisë.



Kur një personi i përshkruhet oksimorfina, ai duhet ta marrë atë saktësisht siç i është përshkruar nga mjeku dhe duhet të përmbahet nga rritja e dozimit ose ndryshimit të metodës së administrimit, pa u konsultuar së pari me mjekun.

Për shkak se oksimorfina shkakton varësi dhe për shkak të efekteve të tjera që i shkakton, ndalimi i përdorimit pa ndihmë profesionale mund të jetë edhe i vështirë edhe i rre-

zikshëm. Abuzimi i oksimorfinës është shumë i rrezikshëm. Ilaçi shkakton ngadalësimin e frymëmarrjes dhe rrahje të shpejta të zemrës, veçanërisht kur abuzohet në doza të larta ose të shpeshta. Abuzimi gjithashtu mund të çojë në rritjen e rrezikut të mbidozës për shkak të grumbullimit të ilaçit në trup, qoftë në një kohë të shkurtër ose një periudhe të zgjatur kohore.

Për shkak se oksimorfina është një ilaç narkotik, përdorimi i tij shkakton shumë efekte anësore dhe rreziqe, risku rritet kur një person abuzon me ilaçin. Më të rrezikshmet nga këto efekte përfshijnë efekte në tru dhe trup, varësinë në përgjithësi dhe varësinë fizike.

Personi mund të ketë një numër efektesh të tjera anësore, në varësi të mënyrës së abuzimit. Për shembull, një person që shtyp dhe nuhatë një tabletë me oksimorfinë mund të përjetojë efekte anësore të abuzimit, siç janë dëmtimi i zgavrave të hundës. Personi që shtyp tabletat për të marrë substancën në mënyrë intravenoze mund të pësojë efekte anësore të abuzimit, të tilla si dëmtimi në vendin e injeksionit, një rrezik i rritur nga infeksioni me sëmundje infektive dhe lezione⁸² të lëkurës.

Një person që abuzon me oksimorfinë mund të zhvillojë një varësi prej tij për vetëm dy javë ose më pak. Dozat e larta ose të shpeshta të oksimorfinës mund të çojnë në depresion të frymëmarrjes, arrest kardial, një kombinim që mund të jetë fatal nëse lihet i pa trajtuar.

82 Lezioni i lëkurës është një term jo specifik që i referohet çdo ndryshimi në sipërfaqen e lëkurës; mund të jetë beninj, malinj ose para malinj.

METADONI

Opiatet sintetike (Metadoni, Tramadolli dhe Fentanili)

Metadoni përdoret si nga ana mjekësore ashtu edhe në mënyrë të paligjshme. Ilaçi konsiderohet një substancë narkotike, do të thotë se është pranuar për përdorim mjekësor dhe mund të përshkruhet me ligj nga mjekët në të gjitha vendet e botës, i përshkruar për të trajtuar dhimbje të forta, kronike, siç janë ato që shkaktohen nga kanceri.



Përdoret gjithashtu shpesh për të trajtuar varësinë nga heroina. Edhe pse metadoni konsiderohet si një alternativë më e sigurt sesa disa narkotikë të tjerë, ilaçi ende bart një rrezik të lartë abuzimi dhe efekte anësore të rrezikshme.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, mjekët gjermanë kanë përdorur ilaçin e ri sintetik për mjekimin e ushtarëve, kur furnizimet me morfinë janë zvogëluar. Ilaçi, i zhvilluar një dekadë më parë nga shken-

cëtarët gjermanë Max Bockmühl dhe Gustav Ehrhart, është pranuar si një zëvendësues efektiv dhe më pak i varur për qetësuesit e dhimbjeve si morfina dhe opiumet.

Ky opioid sintetik vepron në mënyrë të ngjashme me morfinën dhe derivatet e saj; filloi të përdoret në vitet '60 të shekullit të kaluar në terapinë e zëvendësimit të varësisë nga heroina. Metadoni nuk shkakton eufori, nuk qetëson dhe nuk vepron si një analgjetik, por zvogëlon dëshirën për drogë. Sipas të dhënave të fundit, mesatarisht 35% e të varurve nga opiumi në botë trajtohen me këtë ilaç dhe qëllimi i terapisë mund të jetë abstenimi i plotë ose zvogëlimi i dëmit të shkaktuar nga konsumimi i narkotikëve të tillë. Kohët e fundit në terapinë e zëvendësimit, është duke u përdorë buprenorfina, efekti i së cilës është i



ngjashëm me atë të metadonit, por është shumë më i butë.

Përveç qetësimit të receptorëve të opioideve në tru dhe normalizimin e funksioneve të tyre, metadoni ka një efekt më të gjatë dhe nuk aplikohet në vena, por merret në mënyrë orale (me gojë), në formën e pikave të tretura në ujë ose

lëng. Efektet e tjera të lidhura me abstinencën e heroinës nuk duhet të harrohen: trajtimi me këtë opioid sintetik zvogëlon numrin e vdekjeve nga mbidozimi dhe shkallën e krimit të lidhur me heroinën, ndërsa zvogëlon rrezikun e sëmundjeve që vijnë nga përdorimi intravenoz i substancave narkotike, kryesisht HIV dhe hepatit.

Është fakt që terapia merret një periudhë të gjatë të kohës dhe shpesh zgjat me vite. Metadoni shkakton varësi, por pacienti është në një gjendje të vetëdijshme, normale, nuk ka eufori ose krizë të dhunshme të abstinencës dhe mund të kthehet në jetën normale. Nëse merret një vendim i vendosur për të larguar plotësisht varësinë nga heroina, kjo mund të arrihet me metadon: në atë rast, në marrëveshje me pacientin, specialisti kompetent gradualisht do të zvogëlojë dozën e ilaçit.

Metadoni pos mjekimit të varësisë nga heroina mund të përdoret edhe për eliminim e dhimbjeve ekstreme, të cilat janë rezistuese ndaj analgjetikëve të tjerë opioidë, mirëpo për shkak të zhvillimit të varësisë, sot metadoni si analgjetik është braktisur. Prodhohet me emrin komercial heptanon⁸³. Në treg është në formë të tabletave, të ampulave për injektim dhe pika. Përdoret në mënyrë orale, me injektim, e shumë rrallë në mënyrë rektale.

Nëse metadoni keqpërdoret, gjegjësisht përdoret si substancë narkotike, ka veprim të gjatë, shkakton varësi të madhe dhe tolerancë të shpejtë. Veprimi është i ngjashëm me morfinën dhe heroinën, kurse koha e zgjatjes së efekteve është deri 24 orë. Janë të shpeshta rastet e vdekjes nga dozat e tepruara.



83 E prodhon Industria farmaceutike "Pliva" - Zagreb (Kroaci)

TRAMADOLI

Tramadoli është një analgjetik që i përket grupit të opioidëve që veprojnë në sistemin nervor qendror. I përket grupit të analgjetikëve të opiumit, elementi kryesor i të cilit përmban morfinë. Në mjekësi përdoret si ilaç që parandalon dhe lehtëson dhimbjet prej atyre mesatare deri te ato më të forta. Tramadoli nuk është ilaç i cili përdoret për të parandaluar vetëm një dhimbje specifike, por përdoret në rastin e dhimbjeve të mëdha komplekse siç janë dhimbjet pas operacionit, dhimbjet nga kanceri, plagët dhe thyerjet e rënda, nevralgjitë e rënda, sulmet në zemër, dhimbjet gjatë procedurave diagnostikuese dhe terapeutike etj. Shpesh kombinohet me paracetamol për shkak të faktit se ky kombinim është më efektiv në lehtësimin e dhimbjes.

Për sa kohë që merret si ilaç për dhimbje siç rekomandohet nga mjeku, tramadoli nuk shkakton asnjë dëm. Për fat të keq individët bëjnë gabim të tmerrshëm duke e kombinuar atë me ilaçe të tjera ose alkool. Çdo përzierje e tramadolit me ilaçe tjera ose alkool e shndërron atë në një ilaç shumë të rrezikshëm për jetë, kryesisht për shkak të supozimit se është i sigurt vetëm si ilaç që merret me recetë.

Tramadoli fillimisht mendohej se kishte një profil sigurie shumë më të mirë sesa analgjetikët e tjerë opioidë, siç janë morfina ose metadoni, për fat të keq abuzimi i tij është shumë i madh.

Tramadoli gjithnjë e më shumë po abuzohet në vendet e Evropës Perëndimore dhe Ballkanit Perëndimor, më së shpeshti nga varësit nga heroina. Pos që blihet me recetë të mjekut, gjithashtu lehtë mund të gjendet në tregun e zi. Në një periudhë të shkurtër kohore shkakton varësi të madhe, që nxit rritje gjithnjë e më të madhe të dozës.



FENTANOLI

Fentanoli⁸⁴ është një opioid i fuqishëm sintetik i ngjashëm me morfinën, por është 100 herë më i fuqishëm se morfina dhe 50 herë më i fuqishëm se heroina. Në praktikën shëndetësore filloi të përdoret si anestezion intravenoz nën emrin e tregut (komercial) *Sublimaze* në vitet '60.

Të gjithë opioidët për nga fuqia (forca) e tyre si bazë krahasuese marrin morfinën, kështu për shembull, metadoni është tri herë më i fuqishëm se morfina, heroina është rreth 5 herë më e fuqishme, kurse fentanoli është 100 herë më i fuqishëm se morfina. Ky ndryshim dramatik në fuqi, potencialisht ndikon në mbi dozim edhe te substancat narkotike të përmendura (të ndryshme). Pavarësisht se fentanoli është shumë më i fortë se heroina, paradoksisht në tregun e zi ai është shumë më i lirë.



Fentanoli është një ilaç që përshkruhet nga mjeku, që gjithashtu prodhohet dhe përdoret në mënyrë të paligjshme, ilegale. Ashtu si morfina, ky është një ilaç që përdoret zakonisht për të trajtuar pacientë me dhimbje të forta, veçanërisht pas operacionit. Ai gjithashtu përdoret për të trajtuar pacientët me dhimbje kronike dhe që kanë varësi fizike ndaj opioideve të tjerë. Varësia shfaqet kur ndihet nevoja për më shumë sasi dhe më të shpeshta të ilaçit për të arritur efektet e dëshiruara. Fentanoli si ilaç u përdor për herë të parë si një analgjetik intravenoz në klinikat e Evropës në vitin 1963, kurse në Shtetet e Bashkuara në vitin 1968 dhe që atëherë është bërë një nga analgjetikët opioidë më të rëndësishëm dhe më të përdorur në botë. Sot, fentanoli është opioid që përdoret më së shpeshti në mënyrë intravenoze për analgjezinë⁸⁵ intraoperative⁸⁶ në

84 Fentanolin e sintetizoi mjeku belg Paul Adriaan Janssen (1926 - 2003) në vitin 1960.

85 Gjendje analgjezie - lehtësimi i dhimbjeve ose pandjeshmëria ndaj dhimbjeve gjatë dhe pas ndërhyrjeve kirurgjike.

86 Faza intraoperative – përfshin periudhën nga koha e pranimit të klientit në sallën e operacionit, marrja e anesteziës, koha gjatë kryerjes së procedurës kirurgjikale (operacionit) dhe deri sa pacienti të vendoset në dhomën e rimëkëmbjes ose në njësinë e kujdesit post anestetik.

Shtetet e Bashkuara, Kanada, Evropë, Amerikën Qendrore dhe atë të Jugut, Lindjen e Mesme dhe në shumicën e Azisë së zhvilluar dhe Afrikë. Në formën e tij legale fentanoli njihet me emrat si: Actiq, Fentora TM, Duragesic dhe Sublimaze. Emrat në rrugë për fentanilin të përdorur në mënyrë të paligjshme janë: Apache, Girl Girl, China White, Dance Fever, Friend, Goodfellas, Jackpot, Murder 8 dhe Tango & Cash.

Opioidet sintetike, përfshirë fentanolin (të prodhuara ilegalisht), janë sot substancat narkotike më të shpeshta të përfshira në vdekshmërinë nga mbidoza në Shtetet e Bashkuara⁸⁷ dhe Kanada⁸⁸, (posaçërisht në provincën e Kolumbisë Britanike). Fentanili i përdorur në mënyrë të paligjshme, i cili më së shpeshti shoqërohet me mbidoza, prodhohet në laboratorë ilegalë. Ky fentanol sintetik shitet në mënyrë të paligjshme (ilegale) në formë pluhuri, në letër të lubrifikuar, në kutitë e pikave të syrit dhe spërkatjes së hundës ose prodhohet në tableta që i ngjajnë opioideve të tjera.

Stërshitësit e substancave narkotike zakonisht e përziejnë fentanolin me substanca të tjera narkotike, si heroinë⁸⁹, kokainë, metafetaminë dhe MDMA (Ekstazi). Kjo për shkak se nevojitet shumë pak fentanol (një milimikron) për të krijuar eufori të lartë gjë që e bën atë të lirë në tregun ilegal. Kjo është veçanërisht e rrezikshme kur njerëzit që konsumojnë substanca narkotike (cilëndo) dhe nuk kanë njohuri (informacion) se ato përmbajnë fentanol, si shitesë e cila është shumë e rrezikshme. Kështu konsumuesit mund të marrin opioide më të forta duke mos ditur se janë duke marrë fentanol dhe në këtë mënyrë shkaktohet mbidozimi, **ku një e katërta e miligramit, 0.25 miligram, të fentanolit mjafton të shkaktojë vdekjen.**

Pas sintetizimit të fentanolit në vitin 1960, janë zhvilluar shumë analogë të fentanolit për përdorim mjekësor dhe veterinar duke përfshirë: sufentanil, alfentanil, remifentanil dhe carfentanil. analogëve farmaceutikë, përveç **Karfentanolit** i cili është 10 mijë herë më i fuqishëm dhe më toksik se morfina. Karfentanoli është një opioid që përdoret nga veterinarët për kafshë shumë të mëdha si elefantët. Nuk është për përdorim njerëzor. Pavarësisht, çdo substancë që dyshohet se përmban fentanol duhet të trajtohet me kujdes ekstrem, pasi ekspozimi ndaj një sasi të vogël mund të çojë në komplikime të rëndësishme të lidhura me shëndetin ose vdekjen. Përafërsisht është 100 herë më i fortë dhe më toksik sesa fentanoli dhe 10 mijë herë më i fortë dhe më toksik se sa morfina. Kjo do të thotë që carfentanil mund të jetë vdekjeprurës në sasi jashtëzakonisht të vogla.

Fentanoli i kontrabanduar prodhohet kryesisht në Meksikë, kurse fentanoli i pastër importohet nga Kina në Meksikë dhe SHBA. Pastaj fentanyli përpunohet në laboratorë ilegalë duke iu shtuar opioidëve tjerë dhe si përzierje kontrabandohet në SHBA, Kanadë dhe vendet tjera.

87 Në SHBA në katër vitet e fundit (2016-2019) nga mbi doza me opioidë kanë vdekur 248 029 persona, shumica prej të cilëve nga mbidoza me fentanyli. Mesatarisht, 130 amerikanë vdesin çdo ditë nga mbidoza me opioide.

88 Në katër vitet e fundit (2016-2019) në Kanada kanë vdekur 15.393 persona nga mbidoza nga opioidet, 70% prej tyre kanë vdekur nga mbidoza nga fentanyli dhe analogët e tij, kurse mbi 17.000 janë hospitalizuar nga mbidoza me opioidet. (Gjendje kritike ka qenë në provincën perëndimore, Kolumbia Britanike, nga 5 milionë banorë, 5.013 vdekje nga mbidoza me opioide.)

89 Për shkak të vetive të tij të fuqishme opioide, fentanyli me të madhe abuzohet. Fentanyli zakonisht i shtohet heroinës për të rritur fuqinë e saj, ose të maskohet si heroinë shumë e fuqishme. Shumë përdorues besojnë se ata po blejnë heroinë dhe në të vërtetë nuk e dinë që po blejnë fentanil - gjë që shpesh rezulton me vdekje nga mbidoza. Format e paligjshme të fentanilit janë identifikuar dhe vazhdojnë të jenë të lidhura kryesisht me heroinën, si një zëvendësim i heroinës, ose në prodhimin e tabletave farmaceutike të falsifikuara, të cilat imitojnë oksikodonin, hidrokodeonin dhe produktet e alprazolamit.



Simptomat, pasojat dhe shenjat e përdorimit të opioidëve ose opiatëve.

(Opiumi, Morfina, Kodeini, Tebaini, Heroina, Oksikodoni, Bubrenorfina, Metadoni, Tramadoli, Fentanyl)

Simptomat e përgjithshme:

- Lëvizshmëria e ngadalësuar
- Dremitja dhe përgjumja
- Lodhja fizike
- Skuqja dhe kruarja e lëkurës
- Marramendja
- Mungesa e energjisë
- Ndryshimi i ngjyrës së zërit (zëri i lodhur me tonalitete të ulëta)
- Frymëmarrja dhe pulsi i ngadalësuar
- Te intoksimit e mëdha gjumi i thellë, i cili mund të përfundojë me komë dhe vdekje
- Sulmet e shpeshta të lemtës
- Nëse merr drogë me anë të injektimit shihen të shpuarat nëpër damarët e duarve
- Ngushtimi dhe zgjerimi i bebëzave të syve
- Sytë e 'përlotur'
- Lëvizshmëria e ngadalësuar
- Humbja e oreksit
- Ndryshimi i ngjyrës së zërit (zëri i lodhur me tonalitete të ulëta)
- Frymëmarrja dhe pulsi i ngadalësuar
- Rraskapitja

- Te intoksimet e mëdha gjumi i thellë, i cili mund të përfundojë me komë dhe vdekje
- Euforia
- Frymëmarrja e dobësuar
- Mjegullimi i funksioneve mentale
- Pandjeshmëria e dhimbjeve
- Aborti spontan
- Ulja e dëshirës seksuale
- Dëmtimi i dhëmbëve.

Pasojat:

- Varësia e rëndë fizike dhe psikike
- Ankthi
- Shqetësimi
- Halucinacionet
- Etnet
- Ndryshimi i përgjithshëm i personalitetit dhe i sjelljeve
- Kërkesat e mëdha për para
- Shkatërrimi psiko-fizik
- Infektimi me virusin e hepatitit apo AIDS/HIV
- Rreziku nga mbi dozimi
- Prirja e rritur për kriminalitet
- Kriza e rëndë nga mospërdorimi i drogës
- Zgjerimi i bebëzave
- Të dridhurit
- Djersitja e shtuar
- Të rrjedhurit e gjakut nga hunda
- Të vjellat dhe mundimi
- Kapsllëku
- Dëmtimi i venave
- Infektimet bakteriologjike
- Dhimbja e kokës
- Të thatit (ulcera)
- Infektimi i valvuleve të zemrës,
- Artriti dhe problemet e tjera reumatike

Shenjat e përdorimit:

- Gjilpërat apo shiringat
- Lugët e tymosura
- Fashat e ndryshme
- Pambuku
- Rripi
- Brisku.

